

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Gusht, 2004 Nr.6



Zyra për Marrëdhënie me Media dhe Publikime e Kuvendit të Kosovës

KRYEPARLAMENTARI DACI TAKOHET ME
ZËVENDËSIN KRYESOR TË PSSP-SË, BRAJSHO

Me ndryshimet kushtetuese nuk do të prishet baraspesha etnike

Standardet do të përmbushen dhe në këtë aspekt do të japë kontrubutin e tij edhe organi më i lartë legjislativ i Kosovës



Takimi Daci -Brajsho

Angazhimet aktuale rreth realizimit të standardeve, privatizimi si dhe ndryshimet kushtetuese ishin tema thelbësore të takimit të sotëm të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, me zëvendësin kryesor të PSSP-së, Çarls Brajsho, një ditë para se shqyrtimi i procesit të privatizimit dhe propozimi për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese të shtrohen në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci me këtë rast theksoi se procesi i privatizimit duhet të vazhdojë, ndërsa duke folur për standardet ai tha se ato do të përmbushen dhe në këtë aspekt do të japë kontrubutin e tij edhe organi më i lartë legjislativ, që ai udhëheq. Në këtë frymë ky organ do të kryejë të gjitha obligimet që ka marrë. Me ndryshimet kushtetuese Kosova do të jetë multietnike, përkatësisht nuk do të prishet baraspesha etnike. Lidhur me këtë ai theksoi se do të mbeten edhe vendet e rezervuara për minoritete në Kuvendin e Kosovës, pra edhe 10 vendet e rezervuara për serbët. Mirëpo, duhet të dihet se tërë puna rreth ndryshimit të Kornizës Kushtetuese bëhet sipas mandatit të popullit, në funksion të të cilit është edhe përbërja aktuale e Kuvendit. Profesor Daci u shpreh se nuk mund të pajtohet me qëndrimin statik të UNMIK-ut, sepse është e nevojshme që të bëhen ndryshime në Kornizën Kushtetuese në pajtim me kërkesat e kohës.



PËRMBAJTJA:

Hap i parë drejt krijimit të një baze të plotë kushtetuese.....	3
Takime shumë të suksesshme dhe mirëkuptim për synimet e Kosovës.....	11
Reforma e ndarjes administrative të Kosovës dhe reforma e pushtetit lokal në Kosovë.....	13
Analizë e nxjerrë pa një konsultim të gjerë.....	16
Të mos tatimohet veprimtaria krijuese	18
Kosova nuk ka infrastrukturë ligjore për mbrojtjen e monumenteve.....	20

Redaksia:

Sharif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: **038 211 188**

E-mail:

media@assembly-kosova.org

Web faqja:

www.assembly-kosova.org

Hap i parë drejt krijimit të një baze të plotë kushtetuese

Procedurë e rregullt brenda Kuvendit, që të ndryshohen disa pjesë të Kornizës Kushtetuese, që është një nevojë e domosdoshme në mënyrë që të funksionojnë institucionet përfaqësuese dhe qeverisëse të Kosovës. - Këto ndryshime do të ndihmojnë që Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës, në mandatin e ardhshëm të pasurohen me kompetenca të reja qeverisëse dhe në një mënyrë të ndihmojnë në përshpejtimin e zgjidhjes finale të statusit të Kosovës.

Në mbledhjen plenare të 8 korrikut, Kuvendi i Kosovës bëri shqyrtimin e Propozimit për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese. Të pranishmit u njoftuan nga kryeparlamentari, Nexhat Daci se në mbështetje të Vendimit të Kuvendit të Kosovës, të datës 30 tetor 2003, Grupi punues ka përfunduar punën në hartimin e amendamenteve në Kornizën Kushtetuese dhe të njëjtat ia përcolli Kryesisë së Kuvendit të Kosovës për shqyrtim të mëtutjeshëm, përkatësisht Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese – konform Rregullës numër 9, të Shtojcës numër 2, Rregullës 14, pika 6 të Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që pas shqyrtimit nga ana e Komisionit, Kryesia t’i radhisë në një nga seancat plenare, procedurë kjo që tashmë është kaluar.

Komisioni ka kërkuar një bashkëpunim, që nga fillimi, me përfaqësuesit e Zyrës ligjore të UNMIK-ut



Propozimin për shqyrtimin e grupit të parë të am e n d a - menteve, si dhe arsyetimin e tyre, e paraqiti Arsim Bajrami, kryetar i Komisionit

legjislativ.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do t’i japë mbështetje parimore dhe konkrete

këtyre amendamenteve, edhe pse jemi të vetëdijshëm se këto amendamente janë larg dëshirës reale të qytetarëve të Kosovës dhe të popullit të Kosovës për të pasur një kushtetutë të mirëfilltë dhe një kushtetutë të plotë.

Ne vlerësojmë se ky është vetëm një hap i parë drejt krijimit të një baze të ardhshme të plotë kushtetuese dhe një kushtetute të mirëfilltë, e cila do të shprehë tërësisht aspiratat legjitime të popullit të Kosovës.

Mendojmë se këto ndryshime do të ndihmojnë që Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës, në mandatin e ardhshëm të pasurohen me kompetenca të reja qeverisëse dhe në një mënyrë të ndihmojnë në përshpejtimin e zgjidhjes finale të statusit të Kosovës.

Siç dihet, Komisioni ka punuar një kohë të gjatë dhe ka kërkuar një bashkëpunim, që nga fillimi, me përfaqësuesit e Zyrës ligjore të UNMIK-ut dhe në fakt që nga fillimi ky proces ka qenë i hapur për pjesëmarrjen e ekspertëve të Zyrës ligjore të UNMIK-ut. Ata fillimisht kanë refuzuar. Më vonë, qëndrimi i fundit i Zyrës ligjore të UNMIK-ut është që të shtyhet votimi në Kuvendin e Kosovës dhe të formohet një komision i përbashkët, i cili në një të ardhme do të përgatisë zgjidhjet për ndryshimet e Kornizës Kushtetuese. Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen e Kuvendit të Kosovës që pika 14.3 e Kornizës Kushtetuese i jep të drejtë Kuvendit të Kosovës që me mbështetje prej dy të tretave të voto-

jë nismën për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese. Pra, fuqia e këtij Kuvendi është vetëm në dhënien e propozimit. Ndërkaq, autoritet përfundimtar që do të lejojë këto ndryshime kushtetuese, siç dihet, është përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ne mendojmë se ka mjaft hapësirë dhe kohë që eventualisht çështjet kontestuese, derisa të dekretohet lejimi i këtyre amendamenteve, të zgjidhen në raport midis institucioneve të Kosovës dhe UNMIK-ut dhe jemi të vetëdijshëm që pas votimit në Kuvendin e Kosovës ka hapësirë të mjaftueshme që të sqarohen të gjitha çështjet kontestuese, në mënyrë që procesi i ndryshimit të jetë një proces i përbashkët. Një proces i përbashkët, për shkak se vlerësojmë që ai është edhe në interes të vetë UNMIK-ut në mënyrë që të përshpejtohet realizimi i Rezolutës 1244 dhe në një mënyrë të përgatitet edhe zgjidhja finale e statusit të Kosovës, e cila – siç dihet - në vitin 2005 është e mundshme pas evaluimit të standardeve.

Grupi punues, në shumicën e çështjeve, ka arritur t’i harmonizojë ato. Në emër të Grupit Parlamentar propozoj që sot të votohen amendamentet, duke përjashtuar amendamentin për përfaqësimin e minoriteteve, i cili do të mund të përpunohet dhe të harmonizohet me minoritetet tjera dhe amendamentet ku ka alternativa. Domethënë, propozoj që këto amendamente të lëhen për një fazë të mëvonshme, në mënyrë që vërtetë sot në seancën e Kuvendit

të arrihet një konsensus i plotë dhe Kuvendi të jetë njëzëri për këto amendamente, të cilat nuk janë kon-testuese, përfundoi Arsim Bajrami.

Kosova duhet të ketë kushtetutë



Shefi i Grupit Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Sabri Hamiti, theksoi se ne jemi në një procedurë të rregullt brenda Kuvendit, që të ndryshohen disa pjesë të Kornizës Kushtetuese, që është një nevojë e domosdoshme në mënyrë që të funksionojnë institucionet përfaqësuese dhe qeverisëse të Kosovës .

Komisionet e kanë kryer punën. Kuvendi, në faza të mëhershme, i ka përkrahur amendamentet në Kornizë, Grupi ynë Parlamentar mendon se duhet të votohen menjëherë dhe mendojmë që kjo është vetëm një fazë e mundësisë së marrjeve së kapaciteteve qeverisëse të institucioneve të Kosovës, sepse, ju e dini, qëndrimi ynë është që Kosova duhet të ketë kushtetutë dhe ne mendojmë se do ta ketë shpejt.

Për këtë fazë, është domosdo që këto amendamente të votohen dhe ne do t'i votojmë, dhe i thërrasim edhe të tjerët t'i votojnë.



Në emër të AAK-së, Bujar Dugolli, tha se edhe ne deklarojmë edhe një herë mbështetjen tonë dhe do t'i votojmë sot këto amenda-

mente për ndryshime dhe plotësime në Kornizën Kushtetuese. Ashtu siç u tha edhe më herët, kemi disa rezerva tek ato amendamente, sikur që janë te 24-shi, 35-shi dhe 36-shi, që janë me alternativa dhe kërkojmë që këto, pasi janë me alternativa, të mos vëhen në votim, por të harmonizohen

në Komision dhe mes grupeve parlamentare dhe të mos ketë ndarje në këtë aspekt, por t'i unifikojmë dhe çka s'arrijmë sot t'i kryejmë, t'i përfundojmë në seancën e ardhshme.



Në emër të Grupit Parlamentar të tjerëve, Gani Sadik, theksoi se ne më 16 të muajit të kaluar kemi dhënë vërejtjet tona në

Kornizën Kushtetuese për ndryshime. Jemi për ndryshime, por kemi do vërejtje. Për fat të keq, unë vetë ia kam dorëzuar kryetarit të Komisionit vërejtjet tona me shkrim, s'kemi marrë asgjë me shkrim. Tash, me të vërtetë, s'dimë qysh të reagojmë dhe çka të bëjmë .

Ne kemi kërkuar të takohemi me Komisionin, ta sqarojmë këtë problem në mes veti. Po them se jemi për ndryshimin e kushtetutës, por kërkesat tona janë brenda standardeve, brenda Kornizës Kushtetuese. Ato të sqarohen nga Komisioni dhe sigurisht se do të votojmë. Ju lutem, nëse ka mundësi, këtë ditë të mos votohet dhe të heqet prej rendit të ditës kjo pikë.



Në vijim Hilmo Kandiç theksoi se unë kam qenë anëtar i Gruit punues për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese.

SDA Boshnjake në tërësi përkrah që tema që sot është në rendin e ditës rreth Kornizës Kushtetuese të votohet, në pajtim me atë që foli kryetari i Komisionit.

Kuvendi pastaj procedoi sipas amendamentave, ashtu siç ishin paraqitur nga të dy komisionet.

Arsim Bajrami, duke dhënë disa shpjegime lidhur me ato që tha Gani Sadik, theksoi se në Komision është arritur një konsensus i plotë i të gjitha grupeve parlamentare dhe përfaqë-

suesve të minoriteteve, që votimi për amendamentin 21 të shtyhet dhe në ndërkohë Komisioni do të punojë me propozimin që e kanë dhënë përfaqësuesit e minoriteteve dhe me minoritetet, që të harmonizojë çështjet dhe në një nga seancat e ardhshme do të propozojë zgjidhjet për këtë amendament. Pra, është vendim unanim që për këtë seancë të shtyhet votimi për këtë amendament.

Po ashtu, ne kemi rënë dakord që të gjitha amendamentet, ku ka alternativa, e të tilla janë amendamentet 24, 35 dhe 36, të shtyhet miratimi i tyre për një fazë të mëvonshme derisa të tejkalohen këto alternativa dhe derisa të kemi një propozim unik i cili pastaj do të mundësojë edhe një vendimmarrje të kualifikuar çfarë edhe parashihet për këto ndryshime. Përkritazi me këtë Gani Sadik theksoi se gjatë tre vjetëve kemi votuar, jemi me ju – bashkërisht. Ne nuk deshtëm të ndahemi tash. Por, besoj se zgjidhja gjendet, ndoshta mosmarrëveshja ka ekzistuar, e ndoshta edhe unë vetë s'e kam kuptuar, por të bisedojmë me Komisionin, aty ku ka mundësi – të rregullohet. Jemi për kushtetutë , nuk jemi duke e frenuar kushtetutën. Me pajtueshmëri të plotë të deputetëve amendamenti 21, 24, 35 dhe 36 u hoqën nga rendi i ditës.

Në vijim u procedua me aprovimin në tërësi të amendamenteve. Deputetët aprovuan me vota amendamentet, përkatësisht miratuan ndryshimet në Kornizën Kushtetuese, me asnjë votë kundër, ndërsa tre deputetë abstenuan. Miratimin e amendamentave deputetët e përcollën me duartrokitje.

Në vijim Arsim Bajrami, shprehu kënaqësinë që Seanca plenare ka votuar amendamentet. Dëshiroj t'ju njoftoj se bashkë me këto amendamente UNMIK-ut duhet t'i përcillet edhe një pako e vërejtjeve redaktoriale-gjuhësore që janë pjesë e këtyre amendamenteve dhe propozoj që bashkë me këto amendamente t'i bashkëngjiten edhe vërejtjet gjuhësore e redaktoriale, të cilat janë dhënë nga deputeti Hydajet Hyseni

dhe që janë pranuar në parim. Kuvendi i Kosovës, në sesionin plenar të 8 korrikut 2004 ka miratuar 38 amendamente nga 42 amendamente të hartuara nga grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese të Kosovës.

Më poshtë po japim tekstin e plotë të amendamenteve të Kornizës Kushtetuese të Kosovës:

Preambula

Amendament-1

Titulli Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë zëvendësohet me : Kushtetutë e përkohshme

Amendament-2

Shprehja : Institucione të përkohshme të vetëqeverisjes dhe në gjithë tekstin e Kornizës Kushtetuese IPV zëvendësohet me : Institucionet demokratike të Kosovës.

Kreu I

Amendament-3

Pika 1.1. riformulohet:

Kosova është një vend në administrimin e përkohshëm ndërkombëtar dhe të institucioneve demokratike të Kosovës e cila me popullin e vet ka attribute të veçanta historike, politike, juridike, kulturore dhe gjuhësore.

Amendament-4

Pika 1.3 riformulohet:

Komunat janë njësi administrative territoriale bazë të pushtetit lokal me përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i Kosovës.

Shtohet një pikë e re si vijon:

Pushteti lokal në Kosovë organizohet në qytetin e Prishtinës, komuna, dhe njësi administrative lokale.

Organizimi, struktura organizative, kompetencat dhe fushëveprimi i njësisive territoriale rregullohet me ligj të veçantë.

Veprimtaria e mbrendshme e njësisive

administrative territoriale rregullohet me statut dhe akte tjera nënligjore në përputhje me kushtetutë dhe ligj.

Kufinj të Komunave janë të pandryshueshëm. Kufinj të Komunave mund të ndryshohen vetëm në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës.

Amendament-5

Pas paragrafit 1.4. shtohet:

Në Kosovë zbatohet e drejta ndërkombëtare e detyrueshme për të.

Ligjet në Kosovë duhet të jenë në pajtim me marrëveshjet dhe konventat e adoptuara ndërkombëtare.

Në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe në kuadër të kompetencave të tyre, marrëveshje përkatëse ndërkombëtare lidhin Kuvendi, Kryetari i Kosovës, Qeveria dhe organet e pushtetit komunal. Marrëveshjet hyjnë në fuqi pas aprovimit dhe ratifikimit të tyre nga Kuvendi dhe shpalljes së tyre në gazetën zyrtare.

Institucionet e Kosovës përkujdesen për pjesët e komuniteteve të Kosovës dhe banorët e Kosovës që ndodhen jashtë Kosovës, për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit dhe traditave të tyre në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare.

Institucionet e Kosovës anagazhohen dhe bashkëpunojnë me palët e interesuara për përkujdesjen ndaj qytetarëve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë dhe trajtimin e tyre në pajtim me parimet e së drejtës ndërkombëtare.

Cështjet që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe bashkëpunimin ndërkombëtar rregullohen me ligj.

Amendament-6

Pika 1.5 : Pas pikës c) Qeveria, shtohet pika e re ç) Gjykata Kushtetuese e Kosovës, dhe vazhdon renditja sipas tekstit ekzistues.

Amendament-7

Pika 1.6 riformulohet: Kryeqytet i Kosovës është Prishtina

Amendament-8

1.7 riformulohet: Simbolet e Kosovës, përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të tyre rregullohen me ligj.

Kreu III

Amendament-9

Pas pikës 3.4. shtohet pika e re 3.5. si vijon:

"Liritë dhe të drejtat e njeriut rregullohen me ligj të veçantë."

Kreu IV

Amendament-10

Pika 4.2 riformulohet :

Çdo kush ka të drejtë të deklarohet ose të mos deklarohet se cilit komunitet i takon.

Amendament-11

Pas pikës 4.3 shtohet pika e re:

4.4. Institucionet e Kosovës respektojnë dhe zbatojnë standardet evropiane për të drejtat e komuniteteve .

Amendament-12

Pika 4.4 (a) riformulohet:

(a) Të përdorin lirisht gjuhën dhe shkrimin e tyre në gjykata, organe, trupa (organe) publike dhe organizata të tjera të Kosovës;

Pika 4.4 (ç) riformulohet:

(ç) Të gëzojnë të drejta të barabarta dhe adekuate në lidhje me punësimin në organet dhe në shërbimet publike të të gjitha niveleve;

Te pika 4.4 (g) pas fjalës ligjin të fshihen fjalët " e zbatueshëm" në të dy rastet.

Amendament-13

Te pika 4.5 fjalia e dytë "Institucionet e përkohshme sigurojnë.... Fshihet deri në fund.

Amendament-14

Te pika 4.6 pas fjalës PSSP-ja, shtohen fjalët " dhe Institucionet Demokratike të Kosovës"

Amendament-15

Pas pikës 4.6 shtohet pika e re: 4.7.Liritë dhe të drejtat e komuniteteve në Kosovë rregullohen me ligj.

Kreu V

Amendament-16

Në pikën 5.1 (b) fjalia "Në çështjen buxhetore dhe fiskale" zëvendësohet me " Politikën buxhetore dhe fiskale"

Në pikën 5.2 fshihet pika (f).

Amendament-17

1. Institucionet Demokratike të Kosovës kanë përgjegjesi të reja në fushat vijuese:

- FUSHËN E MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE
- FUSHËN E RENDIT, SIGURISË PUBLIKE DHE MBROJTJEN EMERGJENTE
- FUSHËN E DREJTËSISË DHE SISTEMIT GJYQËSOR
- FUSHËN E KONTROLLIT TË KUSHTETUTËSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË
- FUSHËN E PUSHTETIT LOKAL
- FUSHËN E ENERGJETIKËS.

2. Në ushtrimin e përgjegjësive në fushat përkatëse themelohen Institucione ekzekutive dhe gjyqësore. (Bëhet pika 5.9.)

Kreu VI

Amendament-18

Riformulohet Kreu 6 si vijon:
Ligji dhe rendi
Shërbimi Policor i Kosovës

1. Shërbimi Policor i Kosovës është përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike të qytetarëve, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve të Kosovës, luftimin dhe parandal-



imin e krimit, mbledhjen e informacioneve, kryerjen e hetimeve dhe zbulimin e krimit, mbrojtjen e institucioneve të Kosovës dhe sigurimin e sundimit të ligjit.

2. Shërbimi Policor i Kosovës funksionon nën autoritetin e Qeverisë së Kosovës.

3. Shërbimi Policor i Kosovës është institucion i depolitizuar dhe në shërbim të qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës

4. Shërbimi Policor i Kosovës në ushtrimin e funksioneve të tij ndihmohet nga policia nderkombëtare dhe forcat e KFOR-it.

5. Organizimi i SHPK-së, struktura dhe veprimtaria e përgjithshme e saj rregullohen me ligj.

Kreu VII

Riformulohet Kreu 7 si vijon:
Trupat e Mbrojtjes së Kosovës

1. Kosova ka Trupat Mbrojtëse të saj.

2. Trupat e Mbrojtjes së Kosovës është një organizatë profesionale e ndërhyrjes së shpejtë, e themeluar me ligj, e cila në raste fatkeqësish natyrore dhe në raste tjera emergjente në Kosovë ndërmerr detyra për ndërhyrje të shpejtë për sigurinë publike dhe të ndihmës humanitare.

3. Trupat e Mbrojtjes së Kosovës vepron nën autoritetin e PSSP-së dhe të IDK të Kosovës.

4. Trupa e Mbrojtjes së Kosovës paraqet organizatë të depolitizuar, profesionale e bazuar në kodet e sjelljes dhe rregullat e përgjegjësive në shërbim.

5. Organizimi i TMK-së, struktura dhe veprimtaria e përgjithshme e saj rregullohen me ligj.

Kreu VIII

Amendament-20

Nga Kreu 8 pika 8.1. të fshihet nënpika "(e)".

Kreu IX

Amendament-21

Pika 9.1.3. nënpika (b) riformulohet: (b). Njëzet (20) prej 120 vendeve rezervohen për përfaqësim plotësues të komuniteteve joshqiptare të Kosovës në rastin kur ato gjatë procesit zgjedhor nuk kanë arritur që të sigurojnë përfaqësimin proporcional në Kuvendin e Kosovës.

i. Përfaqësimi plotësues i komuniteteve joshqiptare dhe rradhitja e vendeve të tyre duhet të jetë në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata i marrin në zgjedhjet për Kuvend.

ii. Në rastin kur ndonjë nga komu-

nitetet joshqiptare ka siguruar përfaqsimin proporcional në Kuvend nëpërmjet zgjedhjeve, ai komunitet nuk e gëzon të drejtën që të marrë vende të tjera plotësuese.

iii. Në rastin kur të gjitha komunitetet joshqiptare kanë siguruar përfaqsimin proporcional adekuat nëpërmjet zgjedhjeve në Kuvend, atëherë 20 vendet e rezervuara ndahen në proporcion me numrin e votave të fituara midis të gjithë subjekteve politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend.

Pika 9.1.3. nënpika (c) riformulohet:
(c). Çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeçare në ditën e zgjedhjeve dhe që gëzon statusin e qytetarit të Kosovës, ka të drejtën e votës.

Amendament-22

Pika 9.1.4. fjalët " Kohëzgjatja e Kuvendit është tri vjet" zëvendësohet " Mandati i Kuvendit zgjatë katër vjet"

Amendament-23

Pika 9.1.6. nënpika (ç) pas fjalës" dënimin e shqiptuar" shtohet: "nga gjykata e Kosovës ose " dhe vazhdon teksti i vjetër.

Amendament-24

Neni 9.1.7. me pikat a, b, c, ç, d fshihet dhe formulohet ndryshe:

Kuvendi i Kosovës ka Kryetarin dhe katër (alternativë : pesë) nënkryetar, të cilët zgjidhen si vijon:

a) Kryetari dhe një nënkryetar i Kuvendit emërohen nga partia ose koalicioni nga komuniteti shumicë që ka marrë shumicën e votave në zgjedhjet për Kuvend,

b)

1. Një nënkryetar i Kuvendit emërohet nga partia ose koalicioni nga komuniteti shumicë që ka marrë numrin e dytë më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend,

alternativë:

2. Dy nënkryetar të Kuvendit emërohen nga partia ose koalicioni nga komuniteti shumicë që ka marrë numrin e dytë më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend,

c) Një nënkryetar i Kuvendit emërohet nga partia ose koalicioni nga komuniteti shumicë që ka marrë numrin e tretë të votave në zgjedhjet për Kuvend,

ç) Një nënkryetar i Kuvendit emërohet nga partia ose koalicioni që është deklaruar si përfaqësuese e komunitetit serb të Kosovës, përkatësisht e komuniteteve tjera që ka marrë numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend.

Kuvendi i miraton këto emërimet me anë të një vote formale.

Kryetari i Kuvendit dhe nënkryetarët përbëjnë Kryesinë e Kuvendit.

Puna dhe fushëveprimi i nënkryetarve të Kuvendit rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Amendament-25

Te pika 9.1.10 shtohet paragrafi:

Pos komisioneve kryesore dhe atyre funksionale, Kuvendi formon edhe komisione ad hoc.

Amendament-26

Pas pikës 9.1.24 shtohet paragrafi i ri: " Deputeti nuk mund të ndalet, arrestohet ose paraburgoset pa vendimin e Kuvendit mbi marrjen e imunitetit, me përjashtim të rasteve kur zihet në vepër penale që dënohet me më shumë se tri (3) vjet burg."

Amendament-27

1. Në përgjegjësi të Kuvendit të Kosovës është:

- Marrja e vendimit për shpalljen e referendumit dhe përcaktimi i formës së vendimit për të cilin bëhet deklarimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve me të drejtë vote,

- Miratimi dhe ratifikimi i marrëveshjeve të lidhura nga Institucionet demokratike të

Kosovës me vendet tjera,

- Miratimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga fusha e përgjegjësisë së tij,

- Zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me Parlamentet e vendeve të tjera dhe me institucionet ndërkombëtare,

- Ratifikimi i konventave ndërkombëtare dhe përgjegjësia për harmonizimin e ligjeve të Kosovës me legjislacionin ndërkombëtar,

- Angazhimi për integrimin e vet në institucionet parlamentare ndërkombëtare.

2. Ky amendament plotëson dispoziten 9.1.26. të Kornizës Kushtetuese.

Amendament-28

9.1.32, titulli: " Procedurat vendimmarrëse " zëvendësohet me : " Votimi dhe Procedurat vendimmarrëse "

Amendament-29

Në pikat 9.1.33, 9.1.37 dhe 9.1.38. pas fjalisë: Në fund të fjalisë:...dhe që votojnë..., të shtohet fjala: " pa llogaritur ata që abstenojnë ose nuk votojnë fare."

Amendament-30

Në pjesën për Procedurat e miratimit të ligjeve (pika 9.1.34) shtohet paragrafi:

"Nismë legjislative kanë të drejtë të ndërmarrin Qeveria, deputetët, komisionet parlamentare, grupet parlamentare dhe qytetarët që kanë mbështetjen e deponuar me nënshkrime të 20 000 qytetarëve."

Amendament-31

Pika 9.1.41. Pas fjalisë:...një komision i përbërë prej tre vetësh... shtohet: një anëtar, deputet nga ata që mbështesin mocionin, një anëtar, deputet ose zyrtari i lartë i autorizuar nga ata që sponsorizojnë ligjin...

Pika 9.1. 40: fjalia e fundit: Pesë ditë pas marrjes ...etj, bëhet paragraf më vete, siç është në anglisht. Paragrafët

tjerë radhiten në përputhje me këtë ndryshim.

Amendament-32

Pika 9.1.44 riformulohet si vijon:

9.1.44. Kryetari nënshkruan çdo ligj të miratuar nga Kuvendi dhe ia dërgon PSSP-së për shpallje i cili shpalljen e ligjeve e bënë në afat prej 30 ditësh.

Amendament-33

Pika 9.1.48: Fjalja:... në përputhje me legjislacionin e Unmik-ut që drejton zgjedhjet!! riformulohet : " në përputhje me ligjin."

Amendament-34

9.2.3.Riformulohet si vijon :

Mandati i Kryetarit të Kosovës zgjatet 4 vjet.I njejtj person mundet të zgjedhet në këtë detyrë më së shumti dy herë.

Për Kryetar të Kosovës mundet të zgjedhet personi i cili në ditën e zgjedhjes i ka mbushur më së paku 40 vjet.

Amendament-35

Te pika 9.2.4 të fshihet fjala " e zbatueshëm".

Në nënpikën (ç) fjala "një raport" të zëvendësohet me "i drejtohet"

(Alternativë: fjala "një raport" të mos zëvendësohet, të mbetet ashtu si është në tekstin e Kornizës Kushtetuese.).

Në pikën 9.2.4 të plotësohet ushtrimi i funksioneve të Kryetarit të Kosovës me këto nënpika:

Kryetari i Kosovës :

1. Përfaqson Kosovën në relacione me vendet e tjera në të gjitha fushat e përgjegjësive të tij me Kushtetutë e me ligje.
2. Vendos për hapjen e zyrave përfaqësuese të Kosovës në botën e jashtme (alternativë: të hjeket kjo nënpikë e të bartet te kompetencat e Qeverisë),
3. Emëron përfaqësuesit e Kosovës në zyrat përfaqësuese jashtë dhe pranon letrat kredenciale të përfaqësuesve

diplomatikë në Kosovë,

4. Mban kontakte të rregullta me homologët e vet dhe përfaqësuesit e vendeve të jashtme dhe institucionet ndërkombëtare.

5. Vendos mbi çështjet nga sferat e politikës të jashtme dhe marrëdhënjeve ndërkombëtare në pajtimin me Kushtetutën dhe ligjin,

6. Propozon Kuvendit dhe Qeverisë përgaditjen dhe shqyrtimin e çështjeve me interes të përgjithshëm për Kosovë,

7. Mund të merrë iniciativë për mbajtjen e referendumit,

8. Kryen edhe punët tjera të përcaktuara me Kushtetutë.

Amendament-36

Pika 9.2.8, fjalja e fundit riformulohet si vijon:

alternativa 1:

Nëse pas dy votimesh nuk arrihet shumica e dy të tretave, në votimin që vijon kërkohet shumica e votave të deputetëve që votojnë.

alternativa 2:

Nëse edhe në votimin e dytë, kandidati nuk fiton votat e nevojshme, grupi parlamentar me numrin më të madh të vendeve propozon një kandidat të ri për kryetar të Kosovës.

Amendament-37

Te pika 9.2.9 në nënpikën (ç) pas fjalës "Me shkarkimin nga funksioni " shtohet "për shkak të shkeljes së Kushtetutës dhe ligjit," dhe vazhdon teksti i vjetër.

Amendament-38

Pas pikës 9.2.9 shtohet pika e re 9.2.10 si vijon:

Në rastet e pushimit të mandatit të Kryetarit të Kosovës nga pika 9.2.9 funksionin e tij e ushtron Kryetari i Kuvendit por jo më gjatë se 45 ditë mbrenda së cilës kohë duhet të zgjedhet kryetari i ri i Kosovës.

Amendament-39

Shtohet pikë e re në pjesën 9.3.1. për Qeverinë:

Qeveria e Kosovës:

1. Ndërmerrë veprime nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të përgjegjësive të saj,

2. Me ligj të veçantë përcaktohet struktura e brendshme e Qeverisë,

3. Ndërmerrë masa e veprime për krijimin e kushteve për vendosjen e përfaqësive diplomatike në Kosovë.

Amendament-40

Pjesa 9.4: "Sistemi gjyqësor" të ndryshohet dhe të riformulohet kësisoj:

PUSHTETI GJYQËSOR

9.4.1 Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat.

9.4.2 Pushteti gjyqësor është i pavarur.

9.4.3 Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

9.4.4 Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e instancës më të lartë gjyqësore, siguron zbatimin unik të ligjit dhe barazinë e qytetarëve.

9.4.5 Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me mendimin paraprak të Seancës së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me propozim të Kryetarit të Kosovës e zgjedhë dhe emron Kuvendi i Kosovës.

9.4.6 Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës zgjidhet për katër vjet.

9.4.7 Krijimi, fushëveprimi, përbërja dhe organizimi i gjykatave si dhe procedurat gjyqësore rregullohen me ligj.

9.4.8 Seancat gjyqësore janë publike dhe aktgjykimet shpallën publikisht, në emër të Kosovës. Përgjashtimisht nga kjo me ligj mund të përcaktohen rastet e përjashtimit të publikut.

9.4.9 Në gjykime marrin pjesë edhe anëtarët e jurisë (porota).Pjesëmarrja dhe puna e porotës caktohen me ligj.

9.4.10 Gjyqtarët gëzojnë imunitet në harmoni me ligjin.

9.4.11 Gjyqtarët dhe gjyqtarët e jurisë të cilët marrin pjesë në gjykime nuk mund të merrën në përgjegjësi për mendimin e shprehur ose votim gjatë marrjes së vendimit gjyqësor, përveç në qoftë se nuk bëhet fjalë për vepër

penale - shkeljen e ligjit nga ana e gjyqtarit.

9.4.12 Gjyqtari kundër të cilit është nisë procedura penale për veprën penale nga neni 9.4.11 nuk mund të arrestohet pa lejën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

9.4.13 Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet

9.4.14 Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni me rastin e pare të fillimit të ushtrimit të detyrës gjyqtarët emrohen për kohë të kufizuar prej pesë vjet. Pas emrimit të dytë gjyqtari ushtron detyrën e vet në kohë të pakufizuar.

9.4.15 Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Kosovës mbaron kur:

- jep dorëheqjen;
- në qoftë se përherë e humbë aftësinë për të kryer detyrën e gjyqtarit;
- dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi dhe bëhet i padenjë për të kryer detyrën e gjyqtarit;
- në qoftë se në përputhje me ligjin, për shkak të shkeljes së disiplinës, kështu vendos Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

9.4.16 Kundër vendimin mbi shkarkimin nga detyra gjyqtari ka të drejtën e ankimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të vendimit, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

9.4.17 Kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me përgjegjësinë disiplinore, gjyqtari ka të drejtën e ankimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të vendimit, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

9.4.18 Lidhur me ankesat nga paragrafi 4 dhe 5 i këtij neni Gjykata Kushtetuese e Kosovës brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimin të ankesës. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përjashton të drejtën në padi kushtetuese.

9.4.19 Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveçse kur abrogohet gjykata ose këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor në harmoni me ligjin.

9.4.20 Gjyqtari nuk mund të kryej asnjë detyrë ose veprimtari tjetër të cilat ligjit i parasheh si të papajtueshme me detyrën e gjyqtarit.

9.4.21 Gjyqtarët i emron dhe shkarkon dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore vendos Këshilli Gjyqësor i Kosovës në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

9.4.22 Në procedurën e emrimit Këshilli Gjyqësor i Kosovës është i detyruar të sigurojë mendimin e Komisionit përkatës të Parlamentit të Kosovës.

9.4.23 Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka 11 anëtarë më të shquar nga radhët e gjyqtarëve, avokatëve dhe profesorëve universitar, të cilët i emron Parlamenti i Kosovës në mënyrën dhe sipas procedurës së paraparë me ligj. Shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës duhet të vijnë nga radhët e gjyqtarëve.

9.4.24 Kryetarët e gjykatave nuk mund të zgjedheën anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

9.4.25 Anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës emrohen për kohë prej katër vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

9.4.26 Kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës me vota të fshehta e zgjedhë shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për kohë prej dy vjetësh.

9.4.27 Fushëveprimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës rregullohet me ligj.

PROKURORIA

9.4.28 Prokuroria është organ gjyqësor i pavarur, i autorizuar dhe i detyruar të veprojë kundër kryesëve të veprave penale dhe veprave tjera të dënueshme, të ndërmerr veprime juridike me qëllim të mbrojtjes së pasurisë së Kosovës si dhe ushtron mjete juridike për mbrojtjen e Kushtetutës dhe të ligjit.

9.4.29 Prokurorin e Kosovës e emron për kohë prej katër vjet Kuvendi i Kosovës, me propozimin e Qeverisë së Kosovës, me pëlqimin paraprak të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

9.4.30 Me rastin e fillimit të parë të detyrës zëvendësprokurorët e emrohen për kohë prej pesë vjetësh. Pas

emrimit të sërishëm zëvendësprokuro-ri ushtron detyrën e vet në kohë të pakufizuar.

9.4.31 Zëvendësprokurorët i emron, shkarkon dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore vendos Këshilli Prokurorial i Kosovës.

9.4.32 Këshillin Prokurorial të Kosovës e emron Kuvendi i Kosovës në mënyrën dhe procedurën e paraparë me ligj. Shumica e anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit Prokurorial të Kosovës duhet të jenë nga radhët e zëvendësprokurorëve.

9.4.33 Udhëheqësit e prokurorive nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

9.4.34 Organizimi, fushëveprimi dhe mënyra e punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës rregullohet me ligj.

9.4.35 Themelimi, organizimi, fushëveprimi dhe kompetenca e prokurorisë rregullohet me ligj.

Amendament-41

Nëntitulli "Kolegji i veçantë i Gjykatës Supreme mbi çështjet e Kornizës Kushtetuese" të bëhet "Pjesa 9.5", të emërtohet: "GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS" dhe të ketë këtë përmbajtje:

9.5.1 Gjykata Kushtetuese e Kosovës përbëhet prej nëntë gjyqtarëve të cilët i zgjedhë Kuvendi i Kosovës, për kohë prej tetë vjetësh nga radhët e juristëve eminent, sidomos gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe profesorëve universitar të fushës së drejtësisë.

9.5.2 Procedurën e kandidimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe propozimin për zgjedhjen e tyre e zbaton Komisioni përkatës i Kuvendit të Kosovës, kompetent për çështje kushtetuese.

9.5.3 Gjykata Kushtetuese e Kosovës zgjedhë kryetarin e gjykatës për kohë prej katër vjetësh.

9.5.4 Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nuk mund të ushtrjnë asnjë detyrë tjetër publike ose profesionale.

9.5.5 Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës gëzojnë imu-

nitet njësoj si deputetet e Kuvendit të Kosovës.

9.5.6 Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës mund të shkarkohet nga detyra para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhë: në qoftë se jep dorëheqje, në qoftë se dënohet me dënim burgimi, apo në qoftë se me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paaftë për të ushtruar detyrën e vet.

9.5.7 Gjykata Kushtetuese vendos për:

- pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën;
- pajtueshmërinë e akteve tjera normative Kushtetutën dhe me ligjin;
- mund të vlerësojë kushtetushmërinë e ligjit dhe kushtetushmërinë e ligjshmërinë e akteve tjera të cilat kanë pushuar së aplikuari në qoftë se prej atij pushimi deri në kohën e paraqitjes së kërkesës ose të një propozimi për nismën e procedurës nuk ka kaluar më shumë se një vit;
- vendos për paditë kushtetuese kundër vendimeve të veçanta të institucioneve qendrore të Kosovës, të institucioneve dhe të njësisive të vetëqeverisjes lokale në qoftë se me ato vendime janë cënuar liritë themelore dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit si dhe e drejta e vetëqeverisjes lokale e garantuar me Kushtetutën e Kosovës.
- përcjellë realizimin e kushtetushmërisë dhe të ligjshmërisë, si dhe për jokushtetushmërinë dhe joligjshmërinë e vërejtur i raporton Kuvendit të Kosovës;
- vendos për konfliktin e kompetencës midis trupave të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- vendos në përputhje me Kushtetutën për përgjegjësinë e Kryetarit të Kosovës;
- mbikqyrë kushtetushmërinë e programit dhe të veprimtarisë së partive politike dhe, në përputhje me Kushtetutën, mund ta ndalojë punën e tyre;
- mbikqyrë kushtetushmërinë dhe ligjshmërinë e zgjedhjeve dhe të referendumit dhe zgjedhë kontestet të cilat nuk janë kompetencë e gjyqeve;
- kryen punë të tjera të caktuara me Kushtetutë.

9.5.8 Në qoftë se Gjykata Kushtetuese vërteton se një institucion nuk ka nxjerrë dispozita për zbatimin e Kushtetues, ligjit dhe të dispozitave të tjera, të cilat ka qenë i detyruar t'i nxjerrë, për këtë i raporton për këtë Qeverisë, kurse për dispozitat të cilat ka qenë e detyruar t'i nxjerrë Qeveria, për këtë i raporton Kuvendit të Kosovës.

9.5.9 Gjykata Kushtetuese shfuqizon ligjin në qoftë se vërteton se është jokushtetues.

9.5.10 Gjykata Kushtetuese e Kosovës shfuqizon ose anulon aktet tjera normative në qoftë se vërteton se është jokushtetues dhe joligjor.

9.5.11 Në qoftë se Gjykata Kushtetuese, në rastet nga neni 14 paragrafi 1. nënparagrafi 3. i Kushtetutës (Amendamenti 2), vërteton se ligji nuk ka qenë në përputhje me Kushtetutën, ose në qoftë se akti tjetër nuk ka qenë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, nxjerrë vendim për vërtetimin e jokushtetushmërisë dhe joligjshmërisë.

9.5.12 Procedura dhe kushtet për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të pushimit të detyrës së tyre, kushtet dhe afatet për nismën e procedurës për vlerësimin e kushtetushmërisë dhe të ligjshmërisë, procedura dhe zbatimi i vendimeve të saj, mbrojtja e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit dhe çështje të tjera të rëndësishme për kryerjen e detyrës dhe punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përcaktohen me Kushtetutë dhe me ligj.

9.5.13 Ligji Kushtetues nxjerrret sipas procedurës së caktuar për ndryshimin e Kushtetues.

9.5.14 Organizimi i brendshëm i Gjykatës Kushtetuese rregullohet me rregullorën e saj.

Amendament-43

Në Komizën Kushtetuese për Qeverisje të Përkohshme pas Kreut 9 të shtohet Kreu i ri 10 me këtë përmbajtje:

Kreu 10

REFERENDUMI

10.1. Populli, nëpërmjet 50 mijë qyte-

tarëve me të drejtë vote, ka të drejtën të kërkojë nga Kuvendi i Kosovës shpalljen e referendumit për marrjen e një vendimi për çështjet që konsiderohen të një rëndësie të veçantë për mbarë popullin e Kosovës.

10.2. Kuvendi i Kosovës, me propozimin e jo më pak se një së pestës së deputetëve ose me propozimin e Qeverisë, mund të vendosë që një çështje e një rëndësie të veçantë për popullin e Kosovës të shtrohet në referendum.

10.3. Përcaktimi i statusit përfundimtar të Kosovës, mbas fazës transitore të administrimit nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, shtrohet në referendum.

10.4. Të drejtën e referendumit e kanë edhe qytetarët e një komune të Kosovës për çështjet që janë në kompetencë të pushtetit komunal.

10.5. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit parashikohen me ligj.

10.6. Asnjë çështje që ka të bëjë me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve, si dhe me detyrimet financiare të shtetit, nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.

10.7. Gjykata Kushtetuese e Kosovës shqyrton paraprakisht kushtetushmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas pikës 10.1, 10.2, 10.3 e 10.4, brenda 60 ditëve.

10.8. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në, paragrafët 10.1, 10.2, 10.3 e 10.4 nuk është objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese.

10.9. Data e referendumit caktohet nga Kuvendi i Kosovës, përkatësisht ai i komunës, brenda 45 ditëve pas shpalljes së vendimit pozitiv të Gjykatës Kushtetuese ose pas kalimit të afatit brenda të cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet. Kreu egzistues 10 bëhet Kreu 11 e kështu me rradhë.

Kuvendi i Kosovës në sesionin e fundit para pushimeve verore, mbajtur më 28 e 29 korrik, vendosi që 38 amendamentet e miratuara në mbledhjen e mëparshme të 8 korrikut t'ia dorëzojë Zyrës së PSSP-së.

Takime shumë të suksesshme dhe mirëkuptim për synimet e Kosovës

Kryeparlamentari i Kosovës kërkoi marrjen e të gjitha përgjegjësive nga strukturat e zgjedhura të Kosovës, ndërtimin e të gjitha kapaciteteve qeverisëse, kompletimin me të gjitha ministritë, përveç asaj të mbrojtjes, duke theksuar se NATO-ja duhet të jetë përherë prezente në Kosovë, edhe si simbolikë edhe si nevojë për stabilitetin e rajonit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, akademik Nexhat Daci nesër përfundon vizitën disaditëshe në SHBA. Gjatë kësaj vizite kryeparlamentari i Kosovës pati takime në Stejtdepartmentin, Kongresin dhe Senatin e SHBA-ve, e gjithashtu mbajti një ligjeratë në qendrën ndërkombëtare “Vudrov Vilson” si dhe pati një tryezë të rrumbullakët në Stejtdepartment. Çështjet që Kryetari i Kuvendit të Kosovës i shtroi me zyrarët e SHBA-ve kishin të bëjnë me ndërtimin e një strategjie dalëse të UNMIK-ut, pastaj ndërtimi i kapaciteteve të plota qeverisëse të Kosovës, si dhe reforma e pushtetit lokal në Kosovë. Nexhat Daci theksoi se UNMIK-u ishte i suksesshëm në periudhën trevjeçare, ai arriti rezultate shumë të mira në rindërtim dhe në krijimin e strukturave qeverisëse, porse tash është bërë i panevojshëm dhe struktura e tij nuk mund t’i çojë proceset përpara, prandaj duhet të bëhen ndryshime, duke ndërruar mandatin e tij dhe duke u hequr nga nivelet lokale, ndërsa në nivel të Kosovës të ketë mision këshillëdhënës dhe në disa segmente mbikëqyrës, kur është fjala për respektimin e konventave ndërkombëtare dhe aplikimin e ligjit.

Kryeparlamentari i Kosovës theksoi se nuk duhet humbur storja më e suksesshme e interevenimeve ndërkombëtare, e bërë pas Luftës së Dytë Botërore, ajo duhet të përmbillet me sukses duke e marrë përgjegjësinë vetë kosovarët për të ardhmen dhe duke u bërë Kosova vend demokratik i integruar në Evropë dhe në miqësi e në prezencë të përhershme të SHBA-ve në Kosovë, ndaj së cilës populli i Kosovës ka falënderimet më të thella.

Kryeparlamentari i Kosovës kërkoi marrjen e të gjitha përgjegjësive nga strukturat e zgjedhura të Kosovës, ndërtimin e të gjitha kapaciteteve qeverisëse, kompletimin me të gjitha min-



istritë përveç asaj të mbrojtjes, duke theksuar se NATO-ja duhet të jetë përherë prezente në Kosovë, edhe si simbolikë edhe si nevojë për stabilitetin e rajonit. Nexhat Daci në SHBA paraqiti edhe një propozim bazë për strukturimin e pushtetit lokal në Kosovë, duke propozuar krijimin e komunave të reja të Kosovës sipas parimit teritorial dhe të strukturës së popullsisë, duke theksuar se kjo zgjidhje do të ishte në harmoni me kohën, me kërkesat e qytetarëve për shërbime më të mira dhe për plotësim të nevojave dhe kërkesave të qeverisjes lokale. Kryeparlamentari Daci kërkoi ndihmën në forcimin e Shërbimit policor të Kosovës, në ndërtimin e të gjitha strukturave të këtij shërbimi, që do të ishte i aftë të sigurojë qetësinë për të gjithë qytetarët, që do të kontrollonte me sukses kufinj të Kosovës si dhe do të ishte i aftë të luftojë, por edhe të parandalojë krimin e organizuar, si dhe tendencat terroriste ndaj Kosovës. Të gjitha takimet ishin shumë konkrete, me prezentim të faktografisë dhe të argumenteve, se kosovarët dinë dhe mund ta qeverisin plotësisht vendin, në kuadër të Evropës, duke respektuar dhe aplikuar standardet demokratike të repektimit të drejtave

dhe lirive të qytetarëve pa dallim dhe duke respektuar edhe të drejtat dhe liritë etnike, si dhe veçoritë e tjera të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, u shpreh se në SHBA ka ardhur të shprehë falënderimet për ndihmën e deritashme vendimtare për popullin dhe fatin e Kosovës, ka ardhur të informojë për rrjedhat dhe gjendjen aktuale, ka ardhur të prezentojë synimet dhe të ofrojë argumente për vizionin dhe strategjinë e udhëheqjes kosovare, duke kërkuar ndihmën e mëtutjeshme në përfundimin e proceseve të nisura në Kosovë, që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të plota qeverisëse dhe me marrjen e përgjegjësive dhe obligimeve të plota nga institucionet e zgjedhura demokratike të Kosovës. Në të gjitha takimet Kryetari i Kuvendit të Kosovës u prit me mirëkuptim, me respekt për institucionin që e prezenton dhe për vizionet dhe strategjinë për të ardhmen, që edhe në formë të shkruar dhe me kërkesa konkrete i paraqiti përpara zyrtarëve të SHBA-ve, duke u kërkuar një partneritet dhe bashkëpunim të plotë në gjetjen e zgjidhjeve më efikase, më të qëndrueshme dhe më të mira që misioni ndërkombëtar të përmbillet me sukses në Kosovë. Kryeparlamentari Daci theksoi se pavarësia e Kosovës nuk ka alternativë, pasi kjo stabilizon rajonin dhe shpreh zgjidhjen e vetme të drejtë. Pavarësia duhet të arrihet, jo vetëm si synim i kosovarëve, por edhe si bindje dhe synim i miqëve tanë ndërkombëtarë dhe duhet të bëhet në bashkëpunim të plotë dhe partneritet, që do të siguronte edhe garancitë e nevojshme se Kosova do të ishte stabile dhe demokratike dhe se do të kishte garanci të forta për respektim të ligjit dhe të standardeve demokratike të qeverisjes, si dhe respektim të të drejtave të të gjitha grupeve etnike që janë qytetarë të barabartë të Kosovës.

Të plotësohet Qeveria dhe t'i ushtrojmë kompetencat

Nëse nuk përmbushet vullneti i popullit të Kosovës, do të hyjmë në fazën e turbulencave dhe të rreziqeve

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, e ka pritur të deleguarin special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Anan, ambasadorin në NATO, Kai Eide dhe e ka informuar atë me zhvillimet në Kosovës.

Kryeparlamentari Daci në takim me ambasadorin Eide e ka shprehur qëndrimin e tij të njohur për mospërmbushjen e misionit të UNMIK-ut në Kosovë dhe domosdoshmërinë e

ushtrimit të kompetencave më të mëdha nga udhëheqja e vendit.

Vëmendje të veçantë në këtë takim Daci i ka i kushtuar ngecjes së theksuar në planin ekonomik dhe social dhe vonimit të përcaktimit të statusit final të vendit, konform vullnetit popitak të popullit të Kosovës.

Nëse nuk ndryshohet diç në këtë plan, atëherë do të hyjmë në fazën e turbulencave politike dhe të rreziqeve të mëdha, ka tërhequr vërejtjen

profesor Daci. Ai, ndërkaq, ka kërkuar që Qeveria e Kosovës të kompletohet me të gjitha ministrinë, pos Ministrisë së Mbrojtjes.

Nëse nuk përmbushen kërkesat më se legjitime të popullit të Kosovës, atëherë përgjegjësia u takon atyre që nuk lejojnë zhvillimin e kapaciteteve ekonomike, qeverisëse dhe të drejtësisë e të sigurisë në Kosovë, ka qenë i prerë i kryeparlamentari Daci në takim me ambasadorin Eide.

Pakënaqësi me gjendjen materiale në institucionet shkencore



Takimi Daci - Popa

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat Daci, priti sot në një takim, kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Ylli Popa, i cili ishte i shoqëruar edhe nga kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli. Në qendër të vëmendjes së këtij takimi ishin çështjet e bashkëpunimit ndërmjet akademive, pozita shoqërore dhe materiale e tyre, si dhe funksioni i tyre në zhvillimet e gjithëmbarshme. Profesor Daci theksoi se është i pakënaqur me gjendjen materiale në të cilën gjendet Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, e cila nuk ka përkrahje të duhur morale dhe materiale. Nuk mund të pajtohem, tha ai, që ende

nuk e kemi Ligjin për Shkencën, si bazë e zhvillimit më të hovshëm të shkencës dhe institucioneve shkencore përgjithësisht në Kosovë. Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Ylli Popa tha se edhe shkenca në Shqipëri ballafaqohet me këto probleme. Ndërkaq, duke folur për projektet aktuale me të cilat merret kjo Akademi, ai theksoi se Qeveria e Shqipërisë përkrah projekte të këtij institucioni më të lartë të shkencës. Bashkëbiseduesit ishin unanim në konstatimin se bashkëpunimi ndërmjet akademive të Shqipërisë dhe Kosovës është mjaft i frytshëm, me një perspektivë mjaft të mirë të thellimit të mëtejme në të gjithë lëmenjtë e shkencës.

Vullnet i palëkëndur për angazhimin prjës të SHBA-ve në të gjitha proceset që zhvillohen në Kosovë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, akademik Nexhat Daci, priti sot në një takim lamtumirës shefen e Zyrës Amerikane në Prishtinë, z. Marcie Ries. Duke e çmuar lart angazhimin e SHBA-ve në proceset e gjithëmbarshme në Kosovë, si dhe dëshirën për një rol të mëtejme udhëheqës të politikës amerikane në proceset që zhvillohen në Kosovë, kryeparlamentari Daci foli edhe për kontributin e z. Ries dhe të zyrës që ajo udhëheq në këto zhvillime. Në këtë frymë kryeparlamentari Daci foli edhe për rolin udhëheqës e vendimmarrës shumë pozitiv të kësaj diplomateje, sidomos në tre muajt e fundit. Nën udhëheqjen e saj u shënuan më tepër rezultate të stabilizimit të situatës politike dhe të paraqitjes së një perspektive të qartë për Kosovën, se sa një vjet apo dy nën udhëheqjen e UNMIK-ut. Mendimet e z. Marcie Ries kanë qenë vendimtare në pozicionimin tim politik. Akademik Nexhat Daci shprehu besimin e palëkundur që prania e fuqishme e Uashingtonit në Kosovë, bashkë me Brukselin do t'i shkurtojë shumë proceset, duke i mundësuar Kosovës dhe Ballkanit një vizion të qartë të stabilitetit ekonomik e të një standardi më të mirë të jetës që e kemi. Kjo do të krijojë një mjedis të mirë politik drejt proceseve më të mëdha të së ardhmes së Kosovës.

Propozimi bazë :

Reforma e ndarjes administrative të Kosovës dhe reforma e pushtetit lokal në Kosovë

Qëllimet dhe arsyetimet:

Ndarja e tashme territorialo-administrative e Kosovës është e tejkaluar. Në vitet e tetëdhjeta të shekullit njëzet, ishin krijuar disa komuna të reja, duke u bërë kështu gjithsej 31 komuna, më vonë ishin krijuar edhe pesë rrethe administrative.

Kjo strukturë sot nuk i përgjigjet Kosovës, nga fakti se janë krijuar rrethana të reja dhe nga fakti se edhe atëherë ndarja nuk ishte bërë sipas kriterëve fiziko-geografike të terrenit dhe sipas kriterëve të numrit të banorëve, përkatësisht popullsisë e cila në komunën e caktuar dëshiron t'i përmbushë nevojat, të kryejë shërbimet, si dhe të bëjë qeverisjen në nivelin lokal.

Sistemi i vjetër nuk ka mundur t'i përcjellë në masën e duhur standardet evropiane në këtë lëmë, si dhe nuk i janë krijuar kushte edhe nga rregullativa ligjore. Për këtë, synohet që me ndarjen e re administrativo-territoriale të përmbushen kërkesat e qytetarëve, të bëhet ndarje e drejtë që do t'i përshatatet situatës në terren dhe që kjo të bëhet pikërisht me deklarinimin vullnetar nëpërmjet institucioneve nga vetë qytetarët e vendbanimit konkret, të fshatit, të bashkësisë lokale apo të lagjes.

Pas ndarjes së re territoriale do të barteshin, përkatësisht përmes ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës do të përcaktohej niveli i pushtetit, përgjegjësitë dhe obligimet, si dhe i punëve e shërbimeve që kryhen në nivelin komunal, si dhe struktura dhe zgjedhja e organeve të pushtetit.

Ideja:

Duke pasur parasysh që territori i Kosovës është 10.880 kilometra katrorë dhe që numri i banorëve është rreth 2.4 milionë banorë, dhe duke pasur parasysh rrethanat fiziko-geografike të terrenit, të shtrirjes fushore dhe kodrinore, si dhe dendës-

inë e banorëve për kilometër katror, propozojmë që Kosova të ketë dy nivele të ndarjes administrativo-territoriale dhe të pushtetit lokal si një tërësi:

Komuna Qyteti

KOMUNA- Planifikohet që Kosova të ketë rreth shtatëdhjetë komuna si njësi administrative-territoriale. Secila komunë do të kishte nga 70-100 kilometra katrorë, varësisht prej propozimeve të qytetarëve të Kosovës, sa komuna krijohen në gjithë Kosovën, sepse duhet të mblidhen propozimet e jo të krijohen imponime nga qendra, dhe varësisht prej terrenit a është fushor apo kodrinoro-malor. Për shembull, komuna në Rrafshin e Kosovës, apo komuna në rajonin e Gorës, Opojës, të Rugovës, apo të Shalës... do të dallonin ndërmjet vedi për nga territori dhe popullsia.

Kriter duhet të jetë, që territori i komunave të mos jetë më i madh se NJË me DY, që të mos krijojmë komuna gjigante që do t'i ngjanin Rajonit apo Rrethit, por as komuna gjugje që do t'i ngjanin bashkësisë lokale apo fshatit. Madhësia ndërmjet komunave nuk duhet të jetë e dallueshme, edhe nga fakti se kompetencat, dhe detyrat e përgjegjësitë që komuna si njësi territoriale, administrative dhe të themi edhe politike, duhet t'i ketë të njëjta, dhe të rregulluara me ligj.

Duhet të llogaritetet largësia e përafërt e venbanimeve prej qendrës komunale që kjo të jetë mesatarisht prej PESË deri në SHTATË kilometra në vijë të drejtë, që të vendosen kriterë pak a shumë të barabarta të banorëve, në plotësimin e nevojave të pushtetit, të administratës, të shkollimit, të shëndetësisë, të shërbimeve postare, të shërbimeve komunale, publike, zjarrfikësve etj.

QYTETI- Kosova duhet ti ketë shtatë qytete, që janë Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Mitrovica, Prizreni, Peja dhe Gjakova. Këto janë edhe qendra më të mëdha urbane, me dendësi të madhe, karakteristikë për qytetet me koncentrim të madh të banorëve në një hapësirë të vogël. Duhet të përcaktohet qartë dhe në mënyrë të vullnetshme nga banorët, territori i qytetit. Ky territor mandej të ndahet në komuna, duke i marrë për bazë kriteret e caktuara, të numrit të popullsisë, të shtrirjes territoriale, të ndërtimit të infrastrukturës, rrugëve, objekteve publike, shkollave, ambulancave, postës etj. dhe këto komuna të lidhen në Bashkinë e Qytetit.

Komunat e qytetit, duhet të mos e kenë strukturën pushtetore të komunave rurale, sepse as që kanë nevojë për këtë, por të jenë të lidhura në Asambleenë e Bashkisë së Qytetit që bën edhe planifikimin për gjithë hapësirën e territorit të qytetit, normalisht sipas kërkesave dhe koordinimit të vetë komunave të qytetit dhe sipas nevojave dhe prioriteteve të përcaktuara.

Bartja e Pushtetit

Pas ndarjes administrativo-territoriale të Kosovës, që do të bëhet me ligj të miratuar në Kuvendin e Kosovës, pas përcaktimit të territorit të komunave rurale dhe të qyteteve, atëherë bartet pushteti, përkatësisht përcaktohet niveli i pushtetit që në mënyrë autonome realizohet nëpër komuna.

Kjo, ashtu si edhe në çdo vend tjetër, bëhet pas përcaktimit të pushtetit qendror, të karakterit të pushtetit në nivel të Kosovës, sepse tërësia territoriale, administrative dhe politike e Kosovës krijon parakushtet dhe e bën të mundshme ndarjen e bartjen e pushtetit në nivel lokal të komunave. Kjo rregullohet përmes Ligjit të Veçantë për Pushtetin Lokal, përkatësisht të Komunave, ku parashihen funksionet

konkretisht dhe funksionimi i ministrive dhe i shërbimeve të organizuara në kuadër të ministrisë përkatëse, cila pjesë është në nivel të Kosovës, cila në nivel komunal dhe si koordinohen dhe cilat janë përgjegjësitë e komunës dhe të Kosovës.

Komunat do të kenë asamblatë dhe qeveritë e veta të zgjedhura sipas parimit, një qytetar- një votë, por që detyrimisht përmes mekanizmave të caktuar edhe në Kuvend edhe në Qeveri duhet të jetë i garantuar përfaqësimi i gjithë asaj strukture që i karakterizon banorët lokal duke përfshirë, përfaqësimin, politik, gjinor, etnik, fetar etj.

Komuna do t'i kryejë të gjitha punët në teritorin e saj që kryhen në nivel të Kosovës, duke përfshirë administratën, gjyqësinë, policinë, shëndetësinë, të gjitha shërbimet komunale, rrugët, kanalizimin, postën, në nivel të përgjegjësisë dhe detyrave që i ka komuna dhe që parashihen në ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Komunat, varësisht prej numrit të banorëve e interesave, do të përcaktojnë përdorimin e barabartë të gjuhëve e shkrimit në nivel lokal, ndërsa përmes përkthimit dhe në komunikimin me instancat pushtetore, secili qytetar e ruan të drejtën që t'u drejtohet organeve në gjuhën e vet, e të marrë përgjigje poashtu në gjuhën e vet.

Varësisht prej mjeteve të angazhuara materiale dhe mundësive edhe kuadrove e potenciale të tjera, në komuna do të kryhen dhe administrohen shërbimet e caktuara, për shembull në ndërtimin e rrugëve të qendrës komunale dhe të fshatrave, pra të gjitha rrugët e kategorisë së dytë e më poshtë, pastaj kanalizimi, ujësjells, pastrimi, mandej shërbimet shëndetësore, në nivel të shtëpisë së shëndetit, të ambullancave, të postës etj.

Kuptohet rrugët magjistrale, sistemi I gjyqësisë, i policisë, sistemi arsimor, sistemi shëndetësor... mandej të gjitha shërbimet e tjera, postare të energjisë elektrike, do të rregullohen sipas planifikimit në nivel qendror nga ministritë përkatëse, në bashkëpunim me strukturat komunale, duke i shfrytëzuar mundësitë që ato i kanë, si në kuadër ashtu edhe në resurset e tjera.

Çka synohet

Kosova ta ketë sistem funksional të qeverisjes dhe qytetarët e saj më lehtë dhe sipas interesave të tyre t'i realizojnë synimet, dëshirat dhe nevojat, si qytetarë në gjithë gamën e vet, edhe si qytetar i Kosovës, edhe si qytetar i regjionit, krahinës, vendbanimit, por edhe si qytetar i përkatësisë së caktuar etnike, fetare e politike.

Me vetëm një nivel të organizimit administrativ, politik, atë të komunave qytetari i Kosovës pa tensione do t'i realizonte të gjitha kërkesat dhe nevojat e veta, të gjitha përgjegjësitë dhe obligimet që i ka, ndaj vetes, ndaj familjes, ndaj lagjes, fshatit, komunës, ndaj Kosovës, si dhe ndaj përkatësisë etnike dhe fetare të tij.

Të gjitha këto do t'i realizonte vetëvetiu, pa pasur nevojë për tensione

ndarje në momentin e vendosjes së statusit përfundimtar të Kosovës, nën formën "qytetari plus territori", dhe bashkimit me shtetet e tjera...

Me organizimin komunal korpusi i realizimit të të drejtave qytetare është plotësisht i përmbushur dhe në këtë kuadër realizimi i të drejtave etnike, në përdorim të gjuhës, në shkollim, në punësim nuk do të shihej si kundërshti, por si realizim i të drejtave të banorëve lokal të komunës, si pranim i një realiteti ekzistues dhe respektues.

Disa shembuj

Komuna e Hanit të Elezit, skaji më jugor i Kosovës, ku qytetarët e vendbanimit të Hanit të Elezit dhe fshatrat në të dy anët e Grykës së Kaçanikut do t'i realizonin të gjitha synimet e veta si qytetar të Kosovës dhe si banorë lokal. Ky vendbanim sot nën Komunën e



e marrëveshje politike, për koncensus, dhe për arbitrazh të institucioneve ndërkombëtare.

Kosova do të funksiononte si entitet qytetar duke i respektuar dhe duke i mbrojtur edhe veçoritë etnike dhe krahinore të qytetarëve të saj.

Do t'i ikej interesit nacional si pikënisje të organizimit të komunave, dhe si pikënisje për ndarjen e pushtetit lokal. Do t'i ikej krijimit të rajoneve e kantoneve "si mbrojtëse e garantuese" të etnive të caktuara, dhe si burim të kontraktave me pushtetin qendror të Kosovës, dhe si gjendje faktike për ndarje territoriale në vija etnike dhe si

Kaçanikut është i ndarë nga Kaçaniku përmes Grykës shtatë kilometërshe të gjatë, shumë jopraktike dhe të pabanuar, për t'i realizuar interesat dhe obligimet në Kaçanik si qendër komunale. Në Komunën e re banorët do t'i kryenin më lehtë të gjitha shërbimet komunale, do të shfrytëzonin infrastrukturën komunale ekonomike, edhe pikën doganore kufitare edhe Fabrikën e Çimentos, me punësim dhe plotësim të nevojave nga banorët lokal, që edhe jetojnë dhe banojnë aty. Gjithashtu edhe infrastruktura e fshatrave dhe interesat zhvillimore për blegtori në masivin malor të Sharrit dhe të Karadakut do të evidencoheshin e

zhvilloheshin më lehtë, dhe do të gjen-
deshin investitor.

Komuna e Zaskokut do të përfshinte
fshatin Dubravë që jetojnë rreth dy
mijë hashkallij, fshatrat Zaskok,
Pleshinë, Doganaj, Burrnik ku jeton
popullsia shqiptare. Është territor
rrëzë Bjeshkëve të Sharrit, terren edhe
fushor edhe malor që ka veçoritë e
veta të jetesës dhe veçoritë e veta
zhvillimore...

Komuna e Graçanicës, që ka strukturë
etnike me shumicë serbe, që është
komunë fushore, që grupon rreth vetes
fshatra të tjera serbe, si : Prekocin,
Çaglavicën Llapnasellën, por që mund
të inkuadrojë edhe fshatrat shqiptare,
Marecin apo Slivovën. Përmes intere-
save qytetare do të realizoheshin edhe
interesat etnike, në përdorimin e
gjuhës dhe shkrimit, në shkollim, në
punësim etj.

Komuna e Mamushës në rajonin e
Prizrenit e banuar në shumicën me
banorë të nacionalitetit turk

Komuna e Zhurit në Prizren

Komuna e Shalës në Bajgorë të
Mitrovicës

Për të gjitha këto do të jepen karakter-
istikat fiziko-gjeografike, ekonomike,
të pasurive e resurseve, karakteristika
etnike të strukturës së popullsisë, si
dhe përparësitë konkrete të ekzistimit
si komunë dhe përparësitë zhvillimore.
Për të gjitha këto reforma kuptohet se
nevojitet regjistrimi i popullsisë, për të
pasur pasqyrën konkrete të numrit të
banorëve dhe të strukturës së tyre,
edhe etnike edhe gjinore, profesionale
dhe tjetër, por ky nuk është parakusht
sepse mund të mirren referencë
regjistrimet e kaluara, e gjithashtu
popullsia së bashku me territorin janë
elemente të përbashkëta për ndarjen e
re administrativo-teritoriale dhe për
funksionimin e pushtetit lokal.

Gjithashtu konsiderohet se me kom-
pjuterizimin e të dhënave, me ndarjen
e re komunale në Kosovë nuk shtohet
administrata, përkundrazi qytetari

përmes kartës së identifikimit dhe
kodit personal, mund t' i nxjerrë të
gjitha të dhënat dhe të gjithë formula-
rët, për gjendjen civile, kadastrare, për
pagesën e obligimeve tatimore e të
ngjashme. Në zyrat e komunës qyte-
tari do të kishte punë vetëm në evi-
dencim, apo vulosje e vërtetim të
dokumenteve.

Qershor 2004

Vërejtje:

*Propozimi i kryetarit të Kuvendit të
Kosovës për ndarjen administrative të
Kosovës dhe reformën e pushtetit
lokal në Kosovë u është shpërndarë
zyrtarisht edhe partive parlamentare
të Kosovës, Zyrrave të vendeve të
Kuintit, si dhe mediave.*

*Qëllimi i këtij projekti është që të nxitet
debati për reformën në këto çështje dhe
që për këtë ta thonë fjalën komunitatet
dhe qytetarët e Kosovës, të propozojnë
dhe ofrojnë zgjidhjet më të përsh-
tatëshme që janë në interes të tyre dhe
në interes të mbarë Kosovës.*

Kushtetuta e Kosovës të shprehë interesin e të gjithëve

*Nacionalitetet e ndryshme të Kosovës janë begati e saj, janë e mirë e rrethanave historike e kulturore
dhe se i ndihmojnë asaj të bëhet shtet sovran dhe i pavarur*



Nafiye Gaş

Korniza Kushtetuese për Qeverisjen
e Përkohshme në Kosovë e miratuar
si Rregullore e UNMIK-ut, më 15
maj të vitit 2001, është më se e
kuptueshme se në shumë kapituj e
nene të saj duhet të ndryshohet, sepse
nuk është e natyrës, as politike e as
juridike që dokumenti themelor i
Kosovës të mos ndryshojë në fillim
të mandatit të UNMIK-ut, përkatë-
sisht në fillim të ndërtimit të institu-
cioneve demokratike qeverisëse, as
në fund të këtijë mandati, sepse ky
mision nuk mund të jetë i sukseshëm

nëse nuk e bart pushtetin tek institu-
cionet vendore dhe nëse kjo nuk
sanksionohet me Kushtetutën e re të
Kosovës.

Kushtetuta e re nuk duhet të silllet e
miratohet me mbivotim, porse duhet
me konsensus dhe me bashkëbised-
im ndërmjet subjekteve politike.
Edhe ashtu, për miratim të amenda-
menteve nevojiten dy të tretat e
votave të Parlamentit, pra një kon-
sensus i përgjithshëm që të siguro-
hen 81 vota të deputetëve.
Gjithashtu, duhet të kihet kujdes në
marrëdhëniet ndërmjet
nacionaliteteve të ndryshme, që me
shekuj kanë jetuar e punuar së
bashku dhe me shekuj e kanë ndarë
të mirën dhe të keqen.

Konsideroj se nacionalitetet e
ndryshme të Kosovës janë begati e
saj, janë e mirë e rrethanave historike
e kulturore dhe se i ndihmojnë
Kosovës të bëhet shtet sovran dhe i
pavarur.

Për këtë, por edhe për shkak të drej-

tave tashmë të fituara, e edhe për
shkak se këto të drejta nuk i pengojnë
popujtë e tjerë, Grupi parlamentar i
etnive të tjera, nuk pajtohet me asnjë
ndryshim në Kornizën Kushtetuese
me të cilin zvogëlohen apo ridefino-
hen të drejtat e turqëve, boshnjakëve,
goranëve, hashkalinjëve, romëve,
egjiptasëve, si në përfaqësimin në
Kuvendin e Kosovës, përmes
vendeve të garantura, ashtu edhe në
përfaqësimin tjetër dhe në respek-
timin e të drejtave dhe lirive të tyre
kombëtare edhe në përdorimin e
gjuhës dhe shkrimit, në përdorimin e
simboleve kombëtare, si dhe në
shkollim edhe në ruajtjen e kul-
tivimin e traditave kulturore e
veçorive të tjera.

Të drejtat e nacionaliteteve, thënë
kushtimisht të vogla të Kosovës, nuk
duhet të rregullohen me ligj të veçan-
të si propozohet, porse ato duhet të
jenë të garantuara në Kushtetutë si
kategori e barabartë kushtetuese me
të tjerët.

Analizë e nxjerrë pa një konsultim të gjerë

Komisioni për media i Kuvendit të Kosovës, pasi ka marrë Informatën – Analizë mbi raportimin e mediave lidhur me ngjarjet e 17 e 18 marsit, përgatitur nga Komisioneri i Përkohshëm për Media dhe OSBE, si dhe pasi i ka dëgjuar edhe autorët e kësaj analize po edhe palën për të cilën bën fjalë Raporti – përfaqësuesit e mediave, gjithashtu edhe pas komenteve të vetë deputetëve – anëtarë të Komisionit,

VLERËSON

Analiza e Komisionerit... mbi raportimin e tri medimeve qendrore të Kosovës rreth ngjarjeve të 17 e 18 marsit 2004, konsiderohet si material nxitës për një diskutim më gjithëpërfshirës, më të kompletuar e të argumentuar lidhur me raportimin e tri medimeve kosovare, një mediumi publik dhe dy private që mbulojnë hapësirën kosovare.

Duke shprehur mirëkuptim me një pjesë të kësaj Analize, Komisioni parlamentar për media, thekson me keqardhje se ka qenë i anashkaluar madje edhe për konsultim sa i përket përgatitjes së kësaj Analize.

Si e këtillë, kjo Analizë, e nxjerrë pa një konsultim të gjerë dhe duke anashkaluar subjektet vendore të kësaj fushe, vlerësohet e njëanshme edhe në qasje dhe, me prirje për t'u shfajësuar nga përgjegjësia që realisht e ka ndaj medimeve.

Analizës... i mungon përgjegjësia më esenciale në pyetjen se pse ka munguar informacioni zyrtar, kush është dashur ta ofrojë këtë dhe mbi kë adresohet kjo përgjegjësi.

Në mungesë të këtij sqarimi, Analiza më tepër shihet si tendencë për disiplinimin e medimeve që, lexuar më thellë, mund të nënkuptohet edhe si përpjekje për disiplinimin e vetë institucioneve të Kosovës dhe shoqërisë kosovare.

Nga Analiza ... tërësisht është anashkaluar Çagllavica dhe bllokimi i

disa rrugëve të Kosovës, të cilat nxitën dhe përshkallëzuan dhunën e shprehur gjatë trazirave të marsit 2004, si dhe roli i mediave serbe që mbulojnë hapësirën kosovare.

SUGJERON

Të punohet me mediat më tepër në rritjen e profesionalizmit, duke përfshirë këtu edhe çështjet e menagjimit me media dhe veçanërisht të organizohen trajnime për mediat, veçmas në temën: Menagjimi i krizave përmes medimeve. Kompetencat për rregullimin ligjor të medimeve elektronike dhe të shkruara të barten sa më parë në institucionet vendore.

Nëse argumentohen shkelje të Kodit Penal nga ana e mediave, me to të merit drejtësia kosovare e jo komisionerët, qofshin ata ndërkombëtar apo vendor, në rolin e gjykatësëve dhe prokurorëve.

Mediat elektronike kosovare, mbi të gjitha ato qendrore dhe veçanërisht i vetmi medium publik kosovar RTK, mbi bazën e vlerësimeve dhe gjykimeve të drejta, të paanashme dhe të pandikuara nga politika, t' i sanojnë sa më parë dobësitë, të metat dhe veçanërisht raportimet joprofesionale, të emituara jo vetëm nga ngjarjet e 17 e 18 marsit.

Komisioneri i Përkohshëm për Media, si dhe vetë OSBE, vërejtjet e bëra ndaj Analizës, si nga Komisioni parlamentar për media i Kuvendit të Kosovës, ashtu edhe nga asociacione të ndryshme të gazetarëve dhe të vetë menagjmentit të RTK-së, t' i përfshijnë në korrigjimet që do duhej t' ia bëjnë kësaj Analize.

Të manifestohet një bashkëpunim më i madh dhe një respektim i institucioneve të zgjedhura nga vota e popullit prej vetë medimeve dhe prej atyre që monitorojnë me medime.

Zv. Kryesuesi i parë:

Sabit Rustemi

FATMIR SEJDIU PRITI
AMBASADORIN E TURQISË NË
BEOGRAD, HASAN SERVET OKTEM

Në rrugën evropiane Kosova kërkon edhe mbështetjen e Turqisë

Anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu priti sot ambasadorin e Turqisë në Beograd, Hasan Servet Oktem, i shoqëruar nga Metin Këllëq, shef i Zyrës së Turqisë në Prishtinë. Duke njoftuar mysafirët për strukturën e Kuvendit të Kosovës, Fatmir Sejdiu theksoi se në Parlament merr pjesë edhe partia turke, me të cilin kemi bashkëpunim mjaft të mirë. Komuniteti turk në Kosovë ka qëndrim konstruktiv ndaj proceseve aktuale që zhvillohen në Kosovë, ai sheh fatin e përbashkët me kosovarët dhe përkrah opcionin për pavarësi të Kosovës. Ne duam një Kosovë të pavarur për të gjithë qytetarët që jetojnë këtu. Ngjarjet e marsit nuk i kemi pritur mire, as si institucione, as si popull, sidomos djegien e shtëpive dhe të objekteve fetare. Për këto ngjarje ende Parlamenti i Kosovës nuk e ka dhënë vlerësimin përfundimtar, koha do të tregojë të vërtetën. Mirëpo, këto ngjarje nuk duhet të na vihen si lak në fyt, ashtu siç dëshiron Beogradi.

Ne jemi pjesë e Evropës, gjithnjë me synim të qartë që të jemi faktor stabiliteti në rajon, ndaj kërkojmë edhe ndihmën e Turqisë për mbështetjen e Kosovës në rrugën e integriteteve evropiane dhe të pavarësisë. Në këtë rrugë duhet të ecim së bashku sinqerisht, megjithëse dikush dëshiron të na pengojë në realizimin e këtyre synimeve. Vazhdimisht është i pranishëm diversioni serb, i cili instrumentalizon serbët e Kosovës për qëllimet e tij, për ta mbajtur gjithnjë në tension Kosovën, sidomos nëpërmjet strukturave paralele.

Në tetor presim një proces fer zgjedhor, ashtu si kaluan edhe zgjedhjet e mëparshme, të cilat u vlerësuan si më të mirat në Evropën Juglindore. Kërkojmë që edhe këto zgjedhje të monitorohen nga BE-ja, theksoi Fatmir Sejdiu.

Takohen parlamentaret e Kosovës me ato të Shqipërisë

Delegacioni i parlamentareve të Kuvendit të Shqipërisë, i përbërë nga Magbule Çeço, Arta Dade, Valentina Leskaj dhe Elida Tepelena, si dhe Ornela Abazi nga Shoqata për zhvillim njerëzor, u pritën në Kuvendin e Kosovës nga paralemntaret e Kuvendit të Kosovës Edita Tahiri, Edi Shukriu, Sala Ahmetaj, Teuta Hadri dhe Sebahate Grajqevci. Në këtë takim të punë, që u zhvillua në një atmosferë tejet të ngrohtë, deputetet biseduan për një spektër çështjesh të rëndësishme në planin politik, kombëtar dhe në mënyrë të veçant për çështjet e gruas. Deputetet e Kosovës njoftuan mysafiret me rrjedhat politike në Kosovë në pesë vjetët e protektoratit, duke vënë theksin në arritjet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova. Në

një elaborim të gjerë për këtë temë, u tha se sfida kryesore e Kosovës është realizimi i vullnetit të popullit për pavarësi, që është kusht themelor për zhbllokimin e proceseve dhe hapjen e perspektivës për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në vazhdim u theksua se gjendja në Kosovë kërkon një qasje të re të bashkësisë ndërkombëtare dhe të politikës vendore, veçmas pas ngjarjeve të marsit dhe se kalimi në politikën “pavarësia dhe standardet se bashku” është imperativ. Duke folur për çështjet e gruas u tha se në Kosovë gruaja ka rolin e saj në proceset politike, mirëpo ka nevojë për rritjen e përfaqësimit të grave në vendimmarrje. Poashtu u theksua nevoja që të krijohen strategji të përbashkëta për faktorizimin e gjithëmbarshtëm të grave shqiptare.

Në procesin e ndriçimit të fatit të të zhdukurve po lihen anash institucionet vendëse të Kosovës

Projektligji për të drejtat e pjesëtarëve të luftës çlirimtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, të familjeve të dëshmorëve dhe viktimave të luftës, i cili gjendet në procedurë në Parlamentin e Kosovës, vështruar nga aspekti i mbrojtjes së të zhdukurve, si dhe shpejtimi i procesit të ndriçimit të fatit të të zhdukurve ishin tema kryesore shqyrtimi në takimin që pati sot kyetarja e Komisionit për persona të rrëmbyer dhe të zhdukur gjatë luftës të Kuvendit të Kosovës, Flora Brovina, me një delegacion të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, në përbërje të të cilit ishin Robert M. Young, këshilltar regjional për Evropën Qendrore dhe Jugperëndimore, me seli në Budapest dhe Udo Wagner, ndihmëskoordinator.

Me këtë rast u tha se nuk mund të jemi të kënaqur me mbrojtjen e familjeve të të zhdukurve, sidomos nëse mbështetemi në Konventën e Kryqit të Kuq dhe të Rezolutës që kanë të bëjnë me të drejtën e familjarëve për të ditur shkakun e vdekjes së personit të familjes. Në titullin e projek-

tligjit nuk përmenden personat e zhdukur, statusi juridik i personit të zhdukur si dhe mekanizmat që mbrojnë familjet e të zhdukurve. Duke folur për ndërlidhshmërinë shqetësuese të procesit të të zhdukurve në Kosovë, Flora Brovina me këtë rast theksoi se në këtë proces po lihen anash vendësit. Kështu, Marrëveshja që u bë ndërmjet UNMIK-ut dhe Komitetit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur la anash institucionet vendëse, madje është bërë edhe Protokollin ndërmjet UNMIK-ut dhe Zyrës së Çoviqit, por kopja e kësaj marrëveshjeje ende nuk na është dorëzuar zyrtarisht, theksoi Brovina. Në këtë mënyrë po shken të drejtat e një populli. Kosova ende nuk ka zyrë për të zhdukurit, por vetëm komision ndërmintor dhe kjo e vështirëson edhe më çështjen e ndriçimit të fatit të zhdukurve.

Flora Brovina kërkoi që Kryqi i Kuq Ndërkombëtar të organizojë një vizitë të Komisionit Parlamentar për persona të rrëmbyer dhe të zhdukur të Kosovës në varrezat masive në Serbi.

Hydajet Hyseni priti parlamentaret e Shqipërisë

Në kuadër të bashkëpunimit ndërparlamentar Kosovë-Shqipëri, sot anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Hydajet Hyseni, ka pritur një delegacion të deputeteve, të kryesuar nga Magbule Çeço, zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë.

Hyseni i ka njoftuar parlamentaret shqiptare me zhvillimet në Kosovë dhe aktivitetet e Kuvendit për miratimin e legjislativës, si kusht shumë i rëndësishëm për ecjen përpara të vendit dhe vendosjen e statusit, konform vullnetit të qytetarëve. Ai e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm bashkëpunimin ndërmjet të parlemanteve të dy vendeve dhe zhvillimet demokratike në funksion të paqes, stabilitetit dhe integritetit. Zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Magbule Çeço dhe deputetet Arta Dade, Edita Tepelena e Valentina Leskaj, kanë konstatuar me kënaqësi zhvillimet pozitive në Kosovë dhe intensitetin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Ato kanë shprehur angazhimin e Shqipërisë për intergimin e vendit në strukturat evropiane dhe evro-atlantike. Parlamentaret shqiptare, ndërkaq, kanë vënë theksin në përvojat parlamentare të Shqipërisë dhe gatishmërinë për ta ndihmuar legjislativin e Kosovës në procedurat e miratimit të ligjeve dhe organizimin e debateve parlamentare. Deputetet shqiptare kanë vlerësuar kuotën e lartë të grave në Kuvendin e Kosovës, por kanë theksuar se parlamentaret e Kosovës duhet të jenë më aktive dhe më të dukshme në skenën politike të Kosovës. Ato janë shprehur qartë se faktorizimi i gruas në procesin e vendimmarrjes politike do të jetë shumë i rëndësishëm për emancipimin politik të Kosovës dhe në instancë të fundit edhe për përcaktimin e statusit të Kosovës.

Të mos tatimohet veprimtaria krijuese

Ky projektligj siguron që të gjitha burimet e të hyrave, pra jo vetëm rrogat, t'iu nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale, kështu që personat e vetëpunësuar dhe ortakët nuk do të mund t'i ikin tatimit. Në këtë mënyrë mundësohet eliminimi i evazionit fiskal. Siguron barazi horizontale në sistemin tatimor që nënkupton se të gjitha burimet e të hyrave tatimohen në mënyrë të barabartë, në mënyrë që të mos ketë kategorizime të gabuara të llojeve të tatimit

Kuvendi i Kosovës ka bërë shqyrtimin e parë të Projektligjit për tatim në të ardhurat personale. Në fjalën hyrëse lidhur me këtë projektligj, ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ali Sadriu, theksoi se nxjerrja e një ligji të tillë është paraparë edhe në Programin ekonomik të Qeverisë, me qëllim që sistemi tatimor i Kosovës të avancohet dhe të jetë afër standardit të Bashkimit Evropian.

Ky Projektligj është paraparë edhe në sferën e përmbushjes së standardeve për Kosovën, prandaj rëndësia e aprovimit të një ligji të tillë është e madhe dhe me interes të shumëfishtë.

Projektligji i propozuar tejkalon mungesat që ishin në rregullore të tatimit të kësaj natyre, që aplikohen vetëm mbi pagat dhe të ardhurat e biznesit dhe qirasë. Për këtë shkak, jemi duke propozuar një tatim të të ardhurave personale me karakter gjithpërfshirës, që do të aplikohet mbi të gjitha burimet e të ardhurave. Ky Projektligj e thjeshtëson strukturën e ligjeve tatimore të të ardhurave në Kosovë dhe i bën ato më të avancuara.

Kush konsiderohet tatimpagues

Për këtë Projektligj kemi vërejtje nga UMNK-u, sepse sipas tyre ky ligj duhet të procedohet si rregullore dhe jo si ligj. Mirëpo, vërejtja në fjalë bie ndesh në njërin anë me standardet para statutit – standarde të cilat u punuan bashkërisht me UNMIK-un, kurse në standardet dhe substandardet para statusit janë vënë shumë veprime për të arritur si ligj dhe jo si rregullore. Nga ana tjetër Kuvendi nuk miraton rregullore, por nxjerr ligje. Pra vërejtja ka qenë

vetëm në emërtim – ta quajmë ligj apo rregullore?

Projektligji është i ndarë në tri pjesë. Pjesa e parë i referohet tatimpaguesit, shkallës tatimore dhe bazës tatimore. Pjesa e dytë i mbulon rregullat për llogaritjen e të ardhurave të tatimueshme nga secili burim, ndërsa pjesa e tretë i propozon procedurat administrative lidhur me pagesat dhe formularët tatimorë.

Sipas këtij Projektligji, tatimpagues konsiderohen personat fizik, rezident dhe jorezident, të cilët fitojnë apo marrin të ardhura bruto nga të gjitha burimet e tyre, siç janë pagat, veprimtaritë e biznesit nga qiratë, nga shfrytëzimi i pasurive, nga interesi, nga devidenta, nga fitimet kapitale, nga fitimi në llogari dhe lojëra tjera të fatit, si dhe çdo burim tjetër që rrit pasurinë neto të tatimpaguesit gjatë periudhës tatimore.

Për një tatimpagues rezident, objekt i tatimit janë të ardhurat e tatimueshme të tij, të realizuara në Kosovë dhe ato të ardhura që burimin e kanë edhe jashtë Kosovës.

Për një tatimpagues jorezident, objekt i tatimit janë të ardhurat e tatimueshme, burimi i të cilëve është vetëm në Kosovë.

Të ardhurat e tatimueshme për një periudhë tatimore nënkuptojnë diferencën në mes të ardhurave bruto të fituara, apo të marra gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejuara sipas këtij Projektligji në lidhje me këto të ardhura neto.

Për secilën periudhë tatimore, tatimi në të ardhura ngarkohet sipas shkallëve tatimore si vijon:

për të ardhurat e tatimueshme vjetore, gjer në shumën 960 euro tatimi

është 0 euro;

për të ardhurat e tatimueshme vjetore nga shuma 960 euro deri në 3.000 tatimi është 5%;

kurse për të ardhurat e tatimueshme vjetore nga 3.000 deri në 5.400 tatimi është plus 10%;

ndërkaq për të ardhurat e tatimueshme vjetore mbi shumën 5.400 euro tatimi është plus 20%.

Me këtë Projektligj janë të përjashtuar nga pagesa e tatimit të të ardhurave bruto nga pagesat, përfaqësitë diplomatike, ose konsulare dhe personat e huaj të zyreve të ndërlidhjes në Kosovë. Janë përjashtuar nga pagesa edhe përfaqësuesit zyrtarë dhe të punësuarit e huaj në organizatat qeveritare dhe joqeveritare që kanë statut të përfitimit publik.

Gjithashtu nga pagesa e tatimit janë përjashtuar pagesat e përfaqësuesve të huaj dhe të të punësuarve të huaj në agjencionet e donatorëve ose kontraktorët e tyre, ose të përfituesve të granteve që merren me ndihimë humanitare, punë rindërtuese të administrimit civil, si dhe pagat e marra nga të punësuarit e huaj dhe zyrtarët vendës të rekrutuar nga Kombet e Bashkuara dhe agjencitë tjera, por jo edhe në institucionet tjera ndërkombëtare që janë në Kosovë. Po ashtu nga paga e këtij tatimi janë përjashtuar edhe pagat nga personeli i huaj, siç janë KFOR-i dhe tjerët. Kurse, vetëm stafi lokal i punësuar në UNMIK është i përjashtuar nga paga e tatimit mbi të ardhurat personale.

Në pjesën e dytë të këtij Projektligji janë përcaktuar rregullat për llogaritjen e të ardhurave të tatimueshme nga secili burim, përkatësisht me

këtë ligj janë përcaktuar rregullat për pagat, rregullat për të ardhurat nga biznesi, rregullat për të hyrat nga qiraja, si dhe ato që kanë të bëjnë me format tjera të burimit të të ardhurave.

Sipas këtij Projektligji, tatimpaguesit që nga veprimtaria biznesore gjatë periudhës vjetore kanë arkëtuar bruto më shumë se 100 mijë euro, duhet të mbajnë librat dhe regjistrimet e treguara. Do të thotë do të bëjnë edhe raportime, ndërkaq paguesit, të cilët kanë arkëtuar arkëtime vjetore bruto nga veprimtaria biznesore 100 mijë e më pak, munden që në mënyrë vullnetare të vendosin për përgatitjen e librave dhe regjistrimet e treguara. Do të thotë është në dëshirën e tyre.

Secili punëdhënës është përgjegjës për të mbajtur në burim dhe për të transferuar në buxhetin e Kosovës tatimin mbi të ardhurat personale për të punësuarit e tij. Një punëdhënës i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, duhet të mbajë në burim dhe të paguajë në buxhetin e Kosovës një shumë prej 20% të të ardhurave bruto. Secili punëdhënës duhet të deklarojë dhe paguajë tatimin e mbajtur në burim brenda 15 dite, pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, kurse deklarimi dhe pagesa bëhet përmes pasqyrës së tatimit të mbajtur në burim, e cila duhet të dorëzohet në një nga bankat e licencuara nga BBK. Secili autoritet publik, organizatë biznesi, bankë apo institucion financiar që kanë pagesa të interesit mbi tatimin në burim në një shumë të barabart me 20% nga paga apo kreditimit të interesit. Kjo vlen edhe për devidenten, lojërat e fatit dhe pagesat e anuiteteve.

Në pjesën e tretë të këtij Projektligji janë të përcaktuara procedurat administrative lidhur me pagesën dhe formularët e prezentuar nga administrata tatimore. Të gjithë tatimpaguesit duhet të përgatisin dhe dorëzojnë në një bankë të miratuar nga administrata tatimore një deklaratë tatimore përpara një prillit të vitit që pason periudha tati-

more. Deklarata duhet të bëhet në formën e përshtuar nga administrata tatimore dhe përfshin midis tjerash të ardhurat bruto nga të gjitha burimet e të ardhurave, zbritjen e lejueshme, të ardhurat e tatimueshme dhe tatimet e detyrueshme.

Sadriu informoi deputetët se ky Projektligj është shqyrtuar gjatë në kontekst të programit ekonomik të Qeverisë, ai i është dërguar agjencioneve të ndryshme, siç është Bordit i Trustit të Pensioneve, Odës Ekonomike dhe të tjerëve, por është diskutuar edhe në seminare publike dhe në Këshillin Ekonomik Fiskal.

Eliminohen shumë dobësi të sistemit të tanishëm tatimor

Haki Shatri tha se ky Projektligj eliminon shumë dobësi të sistemit të tanishëm tatimor. Së pari, qartëson se kush konsiderohet individ kundrejt këtij tatimi dhe kush entitet kundrejt tatimit në fitim, për çka më konkretisht do të sqarohet me një ligj i cili pritet të vijë në Kuvend ditëve të ardhshme. Pastaj, siguron që të gjitha burimet e të hyrave, jo vetëm rrogat, t'iu nënshtrihen tatimit mbi të ardhurat personale, kështu që personat e vetëpunësuar dhe ortakët nuk do të mund t'i ikin tatimit. Në këtë mënyrë mundësohet eliminimi i evazionit fiskal. Siguron barazi horizontale në sistemin tatimor që nënkupton se të gjitha burimet e të hyrave tatimohen në mënyrë të barabartë, në mënyrë që të mos ketë kategorizime të gabuara të llojeve të tatimit.

Ligji parasheh që të tatimohen edhe të hyrat nga shitja e patundshmërive, duke përfshirë këtu edhe shtëpitë personale. Kjo dispozitë mendoj se duhet të shtyhet në Kosovë të paktën edhe për një periudhë të shkurtër, sepse mendoj që është shumë herët që edhe kjo barrë e tatimit t'iu vihet tatimpaguesve kosovarë.

Sabri Hamiti propozoi që kuado në projektligj të përdoret të përdoret termi i tatimueshëm e jo tatueshëm, ndërsa problemi i atyre tatimeve që propozohen mbi një kategori që unë e quaj punë krijuese dhe që kapin

shpikjet, patentet, autorsitë, prej 20%, është një normë shumë e lartë, dhe ndëshkuese për veprimtarinë krijuese-patentuese te ne, kur shoqëria jonë kurrë s'po jep për kurrëgjë.

Xhelal Canziba shfaqti mendimin se rregullat se si kalkulohen të ardhurat për personat e vetëpunësuar duhet të jenë të ngjashme me rregullat për kalkulimin e fitimit të entiteteve, siç parashihet me ligjin e tatimit në fitim, ndërsa tatimi paushall i cili do të anulohet me këtë ligj, vlen edhe për individët edhe për entitetet. Për këtë arsye ne duhet të shqyrtojmë zgjidhjet e mundshme për të dy projektligjet, në mënyrë që të vendosim nëse sistemi i ri si i tërë është i pranueshëm.

Bujar Dugolli kishte mendim të kundërt me deputetin Shatri lidhur me heqjen e qirasë në shitblerjen e pasurisë së patundshme. Dugolli propozoi që kjo nuk bën të hiqet. Është shumë me rëndësi, theksoi ai, që në këtë Projektligj është vendosur që të paguajnë tatim edhe ata të cilët objektet e tyre të mëdha i lëshojnë me qira. Dihet se sa në Kosovën e pasluftës kanë përfituar individ të caktuar dhe asnjë metelik nuk e kanë derdhur në buxhetin e Kosovës dhe sa pasurime të tilla janë bërë, kurse Kosova s'ka përfituar asgjë nga kjo, prandaj është shumë me rëndësi që është vendosur kjo në këtë Projektligj.

Ne përkrahim edhe kërkesën e zotit Hamiti që veprimtaria krijuese nuk duhet të tatimohet dhe ne do të kontribuojmë si Grup Parlamentar që kjo me amendamente të sanksionohet dhe të hiqet nga Projektligji.

Hydajet Hyseni tërhoqi vërejtjen se gjenden në procedurë dy projektligje. Ne na duhen në të vërtetë të dy këto ligje dhe unë mbështes nismën për t'i rregulluar këto me ligj, por do të ishte mirë që të mos i ngatërrojmë. Alush Gashi propozoi që edhe të punësuarit vendës, që janë të punësuar në UNMIK të paguajnë tatim, pasi ata jetojnë këtu, i realizojnë të ardhurat e veta këtu dhe nuk paguajnë tatim në një vend tjetër.

Kosova nuk ka infrastrukturë ligjore për mbrojtjen e monumenteve

Kulla e Gorajve, përkatësisht e Spahijve, ishte edhe një rast për brengosje përkitazi me rrezikun që i kanoset mbarë objekteve kulturore e historike të Kosovës nga shkatërrimi

Komisioni për kulturë , rini e sport i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Lirak Çelaj, zëvendëskryesues i parë, mbajti sot një dëgjimi publik lidhur me shkresën e një grupi qytetarësh të Pejës për Kullën e Gorajve. Në këtë shkresë shfaqet shqetësimi se kësaj kulle i kanoset rreziku i rrënimit dhe i zhvendosjes. Gjatë debatit u tha se ky objekt është në prag të shkatërrimit të plotë, pos nga rrethina që e degradon, po ashtu edhe nga faktori kohë. Kjo shtron nevojën që sa më shpejt të ndërmerret diçka për ruajtjen e këtij monumenti. Me këtë rast u theksua se nuk dihet që për zhvendosjen e këtij monumenti është dhënë ndonjë leje. Kulla e Gorajve, përkatësisht e Spahijve, ishte edhe një rast për brengosje përkitazi me rrezikun që i kanoset mbarë objekteve kulturore e historike të Kosovës nga shkatërrimi , ishte një sinjal për nevojën e një aktualizimi në shkallën më të lartë, të vetëdijësimit të gjerë shoqëror për ruajtjen e monumenteve kulturore të Kosovës, kur dihet se vetëm në Rajonin e Pejës ekzistojnë qindra objekte që kërkojnë kujdes dhe ruajtje nga shkatërrimi i mëtejshëm. Ajo që e vështirësonte tej mase ruajtjen e monumenteve kulturore e historike në vend, është fakti se Kosova nuk ka infrastrukturë ligjore për mbrojtjen e monumenteve. Ekziston Ligji i vitit 1977 për këtë lëmë, por ai nuk është i shoqëruar me akte nënligjore, ndaj praktikisht kjo begati kulturore gjendet në pozitë shumë të rëndë. Këto fakte shtrojnë nevojën që sa më parë të hartohet Ligji për mbrojtjen e monumenteve, për të vënë baza e rend në ruajtjen e monumenteve.



Kulla e Gorajve

Bordi i ART-së i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës

Çështjen se a mos ka pasur shkelje të interesit nacional me rastin e zgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë mund ta konstatojë Kuvendi i Kosovës

Komisioni për transport dhe telekomunikacion i Kuvendit të Kosovës organizoi sot një dëgjim publik për të shqyrtuar procedurat e ndjekura dhe rregullsinë e tenderimit, gjegjësisht të përzgjedhjes së operatorit të dytë të telefonisë mobile në Kosovë. Në këtë dëgjim publik ishte ftuar që të prezantojë dhe të flasë Anton Berisha, kryetar i Bordit të ART-së. Në fillim të këtij shqyrtimi anëtarët e komisionit kishin pikëpamje të ndryshme rreth procedurës së organizimit të këtij dëgjimi publik. Disa anëtarë reagojnë edhe në fjalën hyrëse të kryetares së komisionit, se a thua me disa konstatime mos po prejjudikon çështjen për të cilën diskutohet. Ishte menduar që, në fillim, kryetari i Bordit të paraqesë një raport për tenderin, mirëpo Anton Berisha theksoi se Bordi i ART-së i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës, ndaj raportin për tenderim ia ka dorëzuar organit më të lartë ligjvënës. I njëjti raport i është dorëzuar edhe UNMIK-ut, ndërsa sa i përket pyetjeve ai ishte i gatshëm të përgjigjet , sipas interesimeve të anëtarëve të komisionit. Në pyetjen e kryetares së Komisionit Edita Tahiri, se a është shkelur interesi nacional me rastin e zgjedhjes së Mobikosit,

e cila është trashëguese e infrastrukturës së Mobtelit të Serbisë, Anton Berisha theksoi se ne përgjigjemi për zgjedhjen e kompanisë më të mirë në pikëpamje profesionale, duke respektuar kushtet dhe kriteret e tenderimit, ndërsa shkeljen apo jo të interesit nacional mund ta konstatojë Kuvendi i Kosovës. Berisha theksoi se mund të thotë kategorikisht se është i pastër sa i përket analizës së projektit më të mirë, ne kemi gjykuar ashtu, e Kuvendi mund të vendosë se a mos është shkelur interesi nacional, apo jo .Ai edhe më këtë rast rikonfirmoi se është zgjedhur kompania më e mirë duke u mbështetur në Raportin e Komisionit Special, por edhe në bazë të së drejtës ligjore të Bordit të ART-së, që buron nga Ligji për telekomunikacion dhe mandati i Kuvendit të Kosovës, për të gjykuar se cila kompani për mendimin e tyre paraqet perspektivën më të mirë për ekonominë e Kosovës. Në përcaktimin e ofetuesit më të mirë është marrë parasysh edhe kriteri i pjesëmarrjes e angazhimit të kapitalit vendës. Anton Berisha dha përgjigjet e tij edhe sa i përket mënyrës së zgjedhjes së ART-së , si dhe të kriterëve të zgjedhjes së Komisionit special.

Shumë resurse bujqësore, pak investime

Ministria e Bujqësisë, duke e shqyrtuar gjendjen e rëndë në Kosovë, ka propozuar deri tash tri materiale, prej të cilave dy kanë të bëjnë me heqjen e tarifave dhe shkallëve doganore

Dega themelore dhe strategjike e ekonomisë kosovare është bujqësia. Kosova ka resurse shumë të rëndësishme në lëmin e prodhimitarisë primare dhe të industrisë përpunuese. Pasi që bujqësia është degë strategjike e ekonomisë në Kosovë, stabiliteti ekonomik dhe social varet në rend të parë nga stabiliteti i zhvillimit bujqësor.

Problemi themelor i bujqësisë në Kosovë është mungesa e investimeve kreditore, si dhe masat stimulativë. Për shkak të mungesës së investimeve, të cilat do t'i kishte siguruar Qeveria e Kosovës me instrumente të cilat ajo i ka, deri më tani vetëm donatorët e jashtëm kanë ndihmuar nëpërmes të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, por edhe kjo ndihmë është e pamjaftueshme.

Masat kryesore dhe qëllimet e politikës agrare janë:

Furnizimi i qytetarëve të Kosovës me prodhime cilësore bujqësore me çmime të përshtatshme;

Përmirësimi i jetës për bujqit dhe të gjithë qytetarët tjerë;

Shtimi i konkurrencës së prodhimitarisë bujqësore;

Mbrojtja e mjedisit në fshat dhe e natyrës;

Krejimi i politikës zhvillimore;

Përgatitja e ligjeve dhe dispozitave në këtë lëmë;

Zbatimi i politikës zhvillimore dhe i ligjeve.

Politika tatimore dhe politika e subvencioneve në bujqësinë e Kosovës janë të pamjaftueshme, përkatësisht mungon politika e masave stimulativë për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Ministria e Bujqësisë, duke e shqyrtuar gjendjen e rëndë në Kosovë, ka propozuar deri tash tri materiale, prej të cilave dy kanë të bëjnë me heqjen e tarifave dhe shkallëve doganore.

Këto dy materiale i ka shqyrtuar dhe i ka aprovuar Qeveria e Kosovës dhe ato i ka dërguar për shqyrtim dhe aprovim nga ana e Këshillit ekonomik fiskal. Ky këshill e ka

Bashkësia Evropiane për zhvillimin e bujqësisë në vit siguron 500 milion €
Për zhvillimin e bujqësisë Zvicra siguron një buxhet në shumë prej 150 milion €
Slllovenia gjithashtu 130 milion € edhe pse e dimë se ekonomia dhe bujqësia e tyre është shumë më e zhvilluar se tek ne. Të gjitha trevat kanë mjete stimuluese për zhvillimin e bujqësisë, kurse fermerët e Kosovës këtë mundësi nuk e kanë, ndaj ata ndodhen në një pozitë të pabarabartë me fermerët në rajon.

aprovuar propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ministrisë për Financa.

Versioni punues i materialit Masat për përmirësimin e politikës fiskale dhe tregtare, gjithashtu i është dërguar Qeverisë të Kosovës për shqyrtim.

Qeveria e Kosovës me rastin e shqyrtimit të materialit në parim e ka pranuar versionin punues dhe ka obliguar Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Financave, Doganën dhe KAFAO që të propozojnë versionin përfundimtar të materialit.

Grupi punues i përbërë nga organet e përmendura më lart është i obliguar të propozoj versionin përfundimtar në mënyrë që ky t'i dërgohet Qeverisë për shqyrtim dhe Këshillit ekonomik fiskal për miratim.

Qeveria e Kosovës për zhvillimin e bujqësisë ka marrë masat si më poshtë:

Ka bërë modifikimin e dispozitave të makro-ekonomisë me qëllim të arritjes së shtimit të prodhimeve ushqimore vendore dhe shtimin e kapaciteteve të prodhuesve tanë për eksport në tregun e Ballkanit.

Është duke përgatitur kornizën ligjore dhe ekonomike e cila do të përkrahë aktivitetet bujqësore;

Qeveria do t'i përkrahë investimet private, me këtë rast ajo luan rolin kryesor në krijimin e kornizës përkatëse. Rikonstruktimi i sektorit të pylltarisë me qëllim të kontrollimit të shfrytëzimit të paligjshëm të pyjeve, të ruajtjes së ambientit jetësor dhe të riorga-

nizimit të ekonomisë së pyjeve.

Ofrimi dhe mbajtja e shërbimeve financiare në fshat për investime në sektorin e fshatit: Shërbimi i kursimit dhe i huamarrjes nga ana e institucioneve të fuqishme financiare paraqet parakusht për një sektor më dinamik të fshatit.

Promovon investime në sektorin privat dhe publik, në infrastrukturë dhe shërbime publike.

Vendos bashkëpunim të afërt me komuna, organizata joqeveritare dhe me ndërmarrësit privat, dhe siguron informatat sipas çmimeve të tregut dhe jep këshilla për veprimtarinë fshatare.

Përgatit modernizimin e sistemit bujqësor me qëllim të arritjes së prodhimitarisë optimale në mënyrë që të bëhemi prodhues konkurrues në rajon.

Promovon zhvillimin rural në atë mënyrë që të përparojë balansin me përfaqësimin e gjinive, që kushtet për femra të jenë të njëjta, sikur ato për mashkuj.

Meqenëse Kosova gjindet nën protektoratin e KB-së, shumë ingjerenca janë në kompetencë të administratës së UNMIK-ut, si dhe problemet me të cilat ballafaqohet ekonomia e Kosovës. Mund të thuhet se pothuaj nuk ekziston politika zhvillimore e kësaj dege shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës për shkak të mungesës së mjeteve kualitative.

Deri më tash në këtë degë nuk janë siguruar investime dhe mjete kreditore, si dhe mjete stimuluese për fermerët. Për shkak të mungesës së investimeve të cilat do t'i kishte siguruar Qeveria e Kosovës me instrumentet me të cilat disponon, deri më tani vetëm donatorët e jashtëm kanë ndihmuar nëpërmes organizatave joqeveritare dhe atyre qeveritare, mirëpo kjo ndihmë ka qenë indirekte dhe e orientuar në ndihmë teknike dhe në aftësimin e shërbimeve profesionale.

Danica Laban, këshilltare e lartë politike

Evidenca e ligjeve të proceduara dhe të miratuara në Kuvendin e Kosovës

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljesnga PSSP
1.	Ligji themelor i pensioneve	Qeveria e Kosovës	2002/1	04.07.2002	2002/15 26.07.2002
2.	Ligji për arsimin Fillor dhe të Mesëm	-/-	20022	25.07.2002	2002/19 31.10.2002
3.	Ligji për arsimin e Lartë	-/-	2002B	25.07.2002	2003/14 12.05.2003
4.	Ligji për Hipotekat	-/-	2002A	17.10.2002	2002/21 20.12.2002
5.	Ligji për Krijimin e Regjistrave për drejtën Pronës	-/-	20025	17.10.2002	2002/22 20.12.2002
6.	Ligji mbi Aktivitetet e Tregëtisë me jashtë	-/-	20026	08.05.2003	2003/15 12.05.2003
7.	Ligji për Telekomunikacionin	-/-	20027	08.05.2003	2003/16 12.05.2003
8.	Ligji për Mbrojtjen e Ambientit	-/-	20028	16.01.2003	20039 15.04.2003
9.	Ligji për Inspektoratin e Punës	-/-	20029	19.12.2002	20034 21.02.2003
10.	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike	-/-	2003/2	08.05.2003	2003/17 12.05.2003
11.	Ligji për Pyjet e Kosovës	-/-	20033	13.02.2003	20036 20.03.2003
12.	Ligji për Likuidimin dhe Riorganizimin e Pers. Jur	-/-	20034	13.03.2003	20037 14.04.2003
13.	Ligji për Farërat	-/-	20035	20.03.2003	200310 15.04.2003
14.	Ligji për Bibliotekat	-/-	20036	04.04.2003	200319 23.06.2003
15.	Ligji për Lëndën Arkivore dhe Arkivat	-/-	20037	17.04.2003	200320 23.06.2003
16.	Ligji për vendosjen e Tatimit në pronën e paluajt.	-/-	20038	17.04.2003	Si Rregullore e UNMIK-ut 2003/29 05.09.2003
17.	Ligji për Kooperativat Bujqësore	-/-	20039	15.05.2003	200321 23.06.2003
18.	Ligji për Plehërat artificiale	-/-	200310	22.05.2003	200322 23.06.2003
19.	Ligji për Rrugët	-/-	200311	29.05.2003	200324 27.06.2003
20.	Ligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare	-/-	200312	26.06.2003	200332 06.11.2003
21.	Ligji për ndrysh. e plotës. të Ligjit 2002/5Regjistr. të pronës	-/-	200313	26.06.2003	200327 18.08.2003
22.	Ligji për Planifikimin Hapësinor	-/-	200314	03.07.2003	200330 10.09.2003
23.	Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale	-/-	200315	11.07.2003	200328 18.08.2003
24.	Ligji për regjistrimin e popullsisë,ekonom familare	-/-	200316	11.07.2003	
25.	Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë	-/-	200317	15.01.2004	2004/3 09.02.2004
26.	Ligji për Shërbime Postare	-/-	200318	09.10.2003	200337 17.12.2003

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljesnga PSSP
27.	Ligji për Siguri në punë,mbrojtje të shëndetit e amb.pu	Qeveria e Kosovës	2003/19	09.10.2003	200333 06.11.2003
28.	Ligji për Pesticidet	-/-	2003/20	16.10.2003	2003/35 08.12.2003
29.	Ligji për ndrysh.e plotësim. të Ligjit 2003/2Menaxh.F.	-/-	2003/21	23.10.2003	200338 17.12.2003
30.	Ligji për Inspektoratin Sanitar	-/-	2003/22	06.11.2003	200339 17.12.2003
31.	Ligji për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar	-/-	2003/23	06.11.2003	200340 17.12.2003
32.	Ligji për Sportin	-/-	2003/24	20.11.2003	
33.	Ligji per Kadaster	-/-	2003/25	04.12.2003	2004/4 18.02.2004
34.	Ligji për produktet dhe paisjet medicinale	-/-	2003/26	04.12.2003	200423 07.07.2004
35.	Ligji për Buxhetin e Kosovës për vitin 2004	-/-	2003/27	22.12.2003	Si Rregullore e UNMIK-ut 2003/41 31.12.2003
36.	Ligji per Transport Rrugor	-/-	2004/1	15.01.2004	Mocion "Kthimi"
37.	Ligji për barazi gjinore	Komisioni për barazi gjinore	2004/2	19.02.2004	2004/18 07.06.2004
38.	Ligji kundër Diskriminimit	Qeveria e Kosovës	2004/3	19.02.2004	Mocion "Kthimi"
39.	Ligji për Shëndetësi	-/-	2004/4	19.02.2004	Mocion "Kthimi"
40.	Ligji për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës	-/-		19.02.2004	Vërejte PSSP+ Mocion
41.	Ligji për Tregëti me Naftë dhe Derivatet e saja	-/-	2004/5	17.03.2004	
42.	Ligji për Transportin e mallrave të rrezikshme	-/-	2004/6	01.04.2004	2004/17 05.06.2004
43.	Ligji për Odën Ekonomike	-/-	2004/7	28.04.2004	
44.	Ligji për Energjinë	Komisioni për Treg. e Indust	2004/8	29.04.2004	2004/21 30.06.2004
45.	Ligji për Rregullatorin e Energjisë	-/-	2004/9	29.04.2004	2004/20 30.06.2004
46.	Ligji për Energjinë Elektrike	-/-	2004/10	29.04.2004	2004/22 30.06.2004
47.	Ligji për Njësitë Matëse	Qeveria e Kosovës	2004/11	29.04.2004	2004/14 28.05.2004
48.	Ligji për Standardizim	-/-	2004/12	29.04.2004	2004/15 28.05.2004
49.	Ligji për Materialin Fidanor	-/-	2004/13	29.04.2004	2004/16 28.05.2004
50.	Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare Financiare	-/-	2004/14	06.05.2004	
51.	Ligji për Ndërtimin	-/-	2004/15	27.05.2004	
52.	Ligji për Vepimtaritë Hoteliere dhe Turistike	-/-	2004/16	27.05.2004	
53.	Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit	-/-	2004/17	16.06.2004	
54.	Ligji për Tregtinë e Brendshme	-/-	2004/18	16.06.2004	
55.	Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve	Kom. për Arsim, Shkencë,	2004/19	16.06.2004	
56.	Ligji për Tatimin në të Ardhura Personale	Qeveria e Kosovës	2004/20	16.06.2004	
57.	Ligji për Veterinarinë	-/-	2004/21	16.06.2004	
58.	Ligji për Kinematografinë e Kosovës	-/-	2004/22	08.07.2004	
59.	Ligji për Tatimin në Fitim	-/-	2004/23	08.07.2004	
60.	Ligji për Ujërat	-/-	2004/24	08.07.2004	
61.	Ligji për detyrimet	-/-	2004/25	28.07.2004	

Nr	Emërtimi i Ligjit	Propozuesi	Nr. i Ligjit	Dt. e Miratimit	Rreg.Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
62	Ligji për trashëgiminë	Qeveria e Kosovës	2004/26	28.07.2004	
63	Ligji për koncesionet	-/-	2004/27	28.07.2004	
64	Ligji për punimet nga metalet e çmuara	-/-	2004/28	28.07.2004	
65	Ligji për plot. e ndryshim të Ligjit 2003B për pyje	Komisioni për Bujqësi e Pylltari	2004/29	28.07.2004	
66	Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Qeveria e Kosovës	2004/30	28.07.2004	
67					
68					
69					
70					

Nr	Emërtimi i Kodit	Sponzorues	Rregullorja Nr. dhe data e shpalljes nga PSSP
1	Kodi Penal i Kosovës	UNMIK	2003/25 dt.06.07.2003
2	Kodi i Procedurës Penale	-/-	2003/26 dt.06.07.2003
3	Kodi Doganor i Kosovës	-/-	2004/1 dt.30.01.2004
4	Ligji Penal për të Mitur	-/-	2004/8 dt.20.04.2004



Pamje nga një mbledhje e Kuvendit të Kosovës

Nr	Emërtimi i Projektligjit	Propozuesi	Data e pranimit	Dt. Shpërndarjes Deputetëve	Shqyrtimi i Parë	Shqyrtimi i Dytë
1	Ligji për ndërmarrjet	Qeveria e Kosovës	11.02.2004	16.02.2004	01.04.2004	Në procedurë
2	Ligji për parkun nacional "Bjeshkët e Nemuna"	-/-	23.02.2004	25.02.2004		
3	Ligji për të drejtat e pjesëtarve të luftës së UÇK	-/-	03.06.2004	04.06.2004	17.06.2004	-/-
4	Ligji për konkurrencën	-/-	14.06.2004	16.06.2004	09.07.2004	-/-
5	Ligji për të drejtat sendore	-/-	21.06.2004	24.06.2004	09.07.2004	-/-
6	Ligji për familjen	-/-	21.06.2004	23.06.2004	09.07.2004	-/-
7	Ligji për nxitjen e investimeve	deputeti Bedri Selmani	23.06.2004	06.07.2004		
8	Ligji për prodhimtarinë blegtorale	Qeveria e Kosovës	29.06.2004	30.06.2004	29.07.2004	-/-
9	Ligji për inspektionin e arsimit të Kosovës	-/-	30.06.2004	30.06.2004	29.07.2004	-/-
10	Ligji kundër korruptionit	-/-	01.07.2004	02.07.2004	29.07.2004	-/-
11	Ligji për lojërat e fatit	-/-	06.07.2004	07.07.2004	29.07.2004	-/-
12	Ligji për drejtat e përgj. e qytetarve në kujdes shëndet	-/-	06.07.2004	07.07.2004	30.07.2004	-/-
13	Ligji për shpalljen e kompleksit memorijal "Adem Jashari"	Kom. Legjisl. e Kornizë Kusht.	06.07.2004	06.07.2004	29.07.2004	-/-
14	Ligji për mbrojtjen civile dhe gadishmëri emergjente	Kom. për gadishmëri emergjente	07.07.2004	08.07.2004		
15	Ligji për avokatinë	Kom. Legjisl. e Kornizë Kusht.	12.07.2004	13.07.2004	30.07.2004	-/-
16	Ligji për tubimet publike	Qeveria e Kosovës	15.07.2004	19.07.2004		
17	Ligji për zeytari	-/-	22.07.2004	23.07.2004		
18	Ligji për drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta	-/-	26.07.2004	28.07.2004		
19	Ligji për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunësuarve	-/-	26.07.2004	28.07.2004		
20	Ligji për librin amzë	-/-	26.07.2004	28.07.2004		
21	Ligji për përdorimin e vulave të IPVQ-ve	-/-	28.07.2004	29.07.2004		
22	Ligji për gazetën zyrtare të Kosovës	-/-	28.07.2004	29.07.2004		
23	Ligji për financimin e partive politike në Kosovë	-/-	28.07.2004	29.07.2004		
24	Ligji për veprimtaritë kërkimore-shkencore	-/-	28.07.2004	29.07.2004		
25	Ligji për administratën tatimore dhe procedurat	-/-	28.07.2004	29.07.2004		
26	Ligji për patenta	-/-	28.07.2004	29.07.2004		
27	Ligji për teatrin	-/-	28.07.2004	29.07.2004		
28	Ligji për mbrojtjen e natyrës	-/-	28.07.2004	29.07.2004		
29	Ligji për shërbimin privat në shëndetësi	-/-	28.07.2004	29.07.2004		

03.08.2004

